



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 22

2003

Prill

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Ligj nr.9021 datë 6.3.2003	Për aderimin Republikës së Shqipërisë në “Konventën e për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër (CITES)	665
Ligj nr.9022 datë 6.3.2003	Për ratifikimin e “Marrëveshjes specifike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë në mbështetje të projekteve për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”	685
Ligj nr.9023 datë 6.3.2003	Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve (ANE)	691
Ligj nr.9024 datë 6.3.2003	Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë	693
Ligj nr.9025 Datë 13.3.2003	Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 9.3.2003 të Këshillit të Ministrave “Për venien në dispozicion të hapësirës tokësore, detare e ajrore dhe dërgimin e një force ushtarake shqiptare në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit”	698

Ligj nr.9026
datë 13.3.2003

Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në “Konventën për njoftimin e shpejtë të një aksidenti bërthamor”	698
Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Shyqyri Matopalaj	704
Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Neim Braho	704
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Veliko Myftaraj	704
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Shpëtim Balija	705
Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Petrit Aliaj	705

L I G J
Nr.9021, datë 6.3.2003

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR TREGTINË
NDËRKOMBËTARE TË SPECIEVE TË RREZIKUARA TË FLORËS DHE FAUNËS SË
EGËR (CITES)**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për tregtinë ndërkombëtare të specieve të rrezikuara të florës dhe faunës së egër (CITES)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3759, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTA
**PËR TREGTINË NDËRKOMBËTARE TË SPECIEVE TË RREZIKUARA TË FLORËS DHE
FAUNËS SË EGËR (CITES)**

Nënshkruar në Uashington, D.C. në 3 mars 1973

Ndryshuar në Bon, më 22 qershor 1979

Shtetet Palë:

duke kujtuar që flora dhe fauna e egër, në format e tyre të shumta të bukura dhe të ndryshme, janë një pjesë e pazëvendësueshme e sistemeve natyrore të tokës që duhen mbrojtur për sot dhe gjeneratat që do të vijnë;

të vetëdijshëm për rritjen e vlerave estetike, shkencore, kulturore, shplodhëse dhe ekonomike të florës dhe faunës së egër;

duke kujtuar që njerëzit dhe shtetet janë dhe duhet të jenë mbrojtësit më të mirë të florës dhe faunës së vendeve të tyre;

duke kujtuar, gjithashtu, që bashkëpunimi ndërkombëtar është baza për mbrojtjen e specieve të caktuara të florës dhe faunës së egër kundër mbishfrytëzimit prej tregtisë ndërkombëtare;

të bindur për urgjencën për marrjen e masave të duhura për këtë qëllim,
ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente, pavarësisht se përmbajtja kërkon ndryshe:

- a) "Specie" kuptohen speciet, nënspeciet ose popullatat e shpërndara gjeografikisht;
- b) "Ekzemplar" kuptohen:
 - i) një kafshë ose bimë e gjallë ose e vdekur;
 - ii) në rastin e një kafshë: për speciet e përfshira në shtojcat I dhe II një pjesë e tyre ose e prejardhur që njihet pa vështirësi; për speciet që përfshihen në shtojcën III, një pjesë e tyre ose e prejardhur që njihet pa vështirësi, specifikuar në shtojcën III në raport me speciet;
 - iii) në rastin e një bime; për speciet e përfshira në shtojcën I, një pjesë e tyre ose e prejardhur që njihet pa vështirësi; për speciet e përfshira në shtojcat II dhe III, një pjesë e tyre ose e prejardhur që njihet pa vështirësi, specifikuar në shtojcat II dhe III në raport me speciet.
- c) "Tregti" kuptohet eksporti, rieksperti, importi dhe hyrja nga deti.
- d) "Rieksperti" kuptohet eksporti i një ekzemplari që ka qenë importuar më parë.
- e) "Hyrja nga deti" kuptohet transporti drejt një shteti i ekzemplarit të ndonjë specie që është marrë në mjedisin detar, që nuk është nën juridiksionin e ndonjë shteti.
- f) "Institucion shkencor" kuptohet një autoritet shkencor kombëtar përcaktuar në përputhje me nenin IX.
- g) "Institucion administrues" kuptohet një autoritet administrues kombëtar përcaktuar në përputhje me nenin IX.
- h) "Palë" kuptohet një shtet, për të cilin kjo Konventë ka hyrë në fuqi.

Neni 2

Parimet kryesore

1. Shtojca I do të përmbajë të gjitha speciet e rrezikuara për zhdukje, që janë ose mund të ndikohen nga tregtia. Tregtia e ekzemplarëve të këtyre specieve duhet të jetë objekt i një rregulloreje strikte të veçantë, me qëllim për të ndaluar rrezikimin e mëtejshëm të jetës së tyre dhe duhet lejuar vetëm në raste të veçanta.
2. Shtojca II do të përmbajë:
 - a) të gjitha speciet që për momentin nuk rrezikohen për zhdukje, por që mund të bëhen të tilla, pavarësisht se tregtia e ekzemplarëve të këtyre specieve është subjekt i rregullave strikte, me qëllim evitimin e shfrytëzimit që rrezikon mbijetesën e tyre;
 - b) specie të tjera që mund të jenë subjekt i rregullave, me qëllim që tregtia e ekzemplarëve të specieve të caktuara sipas paragrafit (a) të kësaj pike, mund të bëhet me një kontroll të efektshëm.
3. Shtojca III do të përmbajë të gjitha speciet, që ndonjë Palë i përcakton si objekt të një rregulloreje brenda juridiksionit të saj, me qëllim parandalimin ose kufizimin e shfrytëzimit dhe, nëse është e nevojshme, bashkëpunimin me Palët e tjera në kontrollin e tregtisë.
4. Palët nuk duhet të lejojnë tregtinë e ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcat I, II dhe III, përveç në përputhje me kushtet e Konventës në fjalë.

Neni 3

Rregullorja e tregtisë së ekzemplarëve të specieve të përfshira në shtojcën I

1. Tregtimi i ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcën I do të kryhet në përputhje me kushtet e këtij neni.
2. Eksporti i ekzemplarëve të specieve të përfshira në shtojcën I duhet të bëhet me një pëlqim paraprak dhe një leje eksporti. Leja e eksportit jepet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
 - a) Institucioni shkencor i shtetit nga eksportohet ka njoftuar që ky eksport nuk do të jetë i dëmshëm për mbijetesën e species.
 - b) Institucioni administrues i shtetit që eksporton është i kënaqur që ekzemplari nuk është marrë në kundërshtim me ligjet e këtij shteti për mbrojtjen e florës dhe faunës.
 - c) Institucioni administrues i shtetit që eksporton është i kënaqur që ndonjë ekzemplar i gjallë duhet të jetë i gatshëm dhe ngarkohet në mënyrë që të minimizohet rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimit të keq të tij.
 - d) Institucioni administrues i shtetit që eksporton është i kënaqur që një leje importi është dhënë për ekzemplarin.
3. Importi i një ekzemplari të specieve të përfshira në shtojcën I duhet të bëhet me pëlqimin

paraprak dhe një leje importi, si dhe një leje eksporti ose certifikate riekspori. Leja e importit do të jepet vetëm kur janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Një institucion shkencor i shtetit që importon ka njoftuar që importi do të bëhet për qëllime që nuk dëmtojnë mbijetesën e specieve në fjalë.

b) Një institucion shkencor i shtetit që importon është i kënaqur që marrësi i pritshëm i ekzemplarit të gjallë ka pajisje të përshtatshme për strehimin dhe ruajtjen e tij.

c) Një institucion administrues i shtetit që importon ka dijeni që ekzemplari nuk do të përdoret për qëllime tregtare parësore.

4. Riekspori i ndonjë ekzemplari të specieve të përfshira në shtojcën I do të bëhet me pëlqimin dhe paraqitjen e një certifikate riekspori. Kjo certifikatë riekspori do të lëshohet vetëm kur janë plotësuar kushtet e mëposhtme:

a) Një institucion administrues i shtetit që rieksporton është i kënaqur që ekzemplari u importua në atë shtet në përputhje me kushtet e Konventës në fjalë.

b) Një institucion administrues i shtetit që rieksporton është i kënaqur që ndonjë ekzemplar i gjallë do të bëhet gati dhe transportohet në mënyrë të tillë, që të minimizohet rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimit të keq të tij.

c) Një institucion administrues i shtetit që rieksporton është i kënaqur që një leje importi është lëshuar për ndonjë ekzemplar të gjallë.

5. Hyrja nga deti i ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcën I do të bëhet me një certifikatë nga institucioni administrues i shtetit ku hyhet. Certifikata do të lëshohet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Një institucion shkencor i shtetit ku hyhet njofton që hyrja nuk do të jetë e dëmshme për mbijetesën e specieve në fjalë.

b) Një institucion administrues i shtetit ku hyhet është i kënaqur që marrësi i pritshëm i një ekzemplari të gjallë është i pajisur të strehojë dhe kujdeset për të.

c) një institucion administrues i shtetit ku hyhet është i kënaqur që ekzemplari nuk do të përdoret për qëllime tregtare parësore.

Neni 4

Rregullat e tregtisë për ekzemplarët e specieve që përfshihen në shtojcën II

1. Tregtia e ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcën II duhet të bëhet në përputhje me kushtet e këtij neni.

2. Eksporti i ndonjë ekzemplari të specieve të përfshira në shtojcën II do të kërkojë pëlqimin paraprak dhe paraqitjen e një leje eksporti. Kjo leje do të jepet vetëm kur të plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Një institucion shkencor i shtetit që eksporton ka njoftuar që ky eksport nuk do të jetë dëmtes për mbijetesën e këtyre specieve.

b) Një institucion administrues i shtetit që eksporton është i kënaqur që ekzemplari nuk është marrë në kundërshtim me ligjet e atij shteti për mbrojtjen e florës dhe faunës.

c) Një institucion administrues i shtetit që eksporton është i kënaqur që ndonjë ekzemplar i gjallë do të jetë i gatshëm dhe transportohet në mënyrë të tillë, që rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimit të keq të tij të jetë minimal.

3. Një institucion shkencor i çdo Pale duhet të vëzhgojë lejet e eksportit të lëshuara nga Shteti për ekzemplarët e specieve të përfshira në shtojcën II dhe eksportin aktual të këtyre ekzemplarëve. Në rastet kur një institucion shkencor përcakton që eksporti i ekzemplarëve të specieve të tilla duhet të zvogëlohet, me qëllim mirëmbajtjen e species në nivele të pranueshme lidhur me rolin e saj në ekosistemet ku jeton dhe mbi nivelin që e bën atë specie të përshtatshme për t'u përfshirë në shtojcën I, institucioni shkencor duhet të këshillojë institucionin administrues për masat që duhen marrë për të zvogëluar dhënien e lejeve të eksportit për ekzemplarët e atyre specieve.

4. Importi i ndonjë ekzemplari të specieve që përfshihen në shtojcën II do të kërkojë paraqitjen paraprake të lejes së eksportit ose një certifikatë riekspori.

5. Riekspori i ndonjë ekzemplari të specieve të përfshira në shtojcën II duhet të bëhet me pëlqimin paraprak dhe paraqitjen e një certifikate riekspori. Një certifikatë e tillë do të lëshohet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Një institucion administrativ i shtetit që rieksporiton është i kënaqur që ekzemplari është importuar në atë shtet në përputhje me kushtet e kësaj Konvente.

b) Një institucion administrativ i shtetit që rieksporiton është i kënaqur që ndonjë ekzemplar i gjallë duhet të bëhet gati ose transportohet në mënyrë të tillë që rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimit të keq të tij të jetë sa më i vogël.

6. Hyrja nga deti i ndonjë ekzemplari të specieve të përfshira në shtojcën II do të bëhet me certifikatë nga institucioni administrues i shtetit ku hyhet. Certifikata duhet të jepet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Institucioni shkencor i shtetit ku hyhet njofton që hyrja nuk do të jetë e dëmshme për mbijetesën e specieve në fjalë.

b) Një institucion administrues i shtetit ku hyhet është i kënaqur që ndonjë ekzemplar i gjallë do të mbahet në mënyrë që të minimizohet rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimit të keq të tij.

7. Certifikatat përmendur në pikën 6 të këtij neni, mund të lëshohen duke marrë mendimin e një instituti shkencor, në bashkëpunim me institucionet e tjera shkencore kombëtare ose, nëse është e nevojshme, institucionet shkencore ndërkombëtare, në një rreth kohor që nuk kalon një vit për numrin total të ekzemplarëve, që do të hyjnë në këtë periudhë.

Neni 5

Rregullorja e tregtisë së ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcën III

1. Tregtia e ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcën III duhet të bëhet në përputhje me kushtet e këtij neni.

2. Eksporti i ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcën III nga shtetet që kanë përfshirë këtë specie në shtojcën III do të bëhet me pëlqimin paraprak dhe paraqitjen e një leje eksporti. Kjo leje do të jepet vetëm kur plotësohen kushtet e mëposhtme:

a) Një institucion administrimi i shtetit që eksporton është i kënaqur që ekzemplari nuk është marrë në kundërshtim me ligjet e atij shteti për mbrojtjen e florës dhe faunës.

b) Një institucion administrimi i shtetit që eksporton është i kënaqur që ndonjë ekzemplar i gjallë duhet të jetë gati dhe transportohet në mënyrë që rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimit të keq të tij të jetë minimal.

3. Importi i ndonjë ekzemplari të specieve të përfshira në shtojcën III do të kërkojë, përveç rasteve kur zbatohet pika 4 e këtij neni, paraqitjen e certifikatës së origjinës dhe, kur importi është prej një shteti që e ka përfshirë atë specie në shtojcën III, një leje eksporti.

4. Në rastin e riekспортit, një certifikatë e dhënë prej institucionit administrues të shtetit që rieksporiton dhe që ai ekzemplar është kaluar në atë shtet ose është rieksportuar do të pranohet prej shtetit që importon si vërtetim që kushtet e kësaj Konvente janë zbatuar në përputhje me ekzemplarin në fjalë.

Neni 6

Lejet dhe certifikatat

1. Lejet dhe certifikatat e dhëna sipas kushteve të neneve 3, 4 dhe 5 do të përgatiten sipas kushteve të këtij neni.

2. Një leje eksporti do të përmbajë informacionin e specifikuar në modelin që ndodhet në shtojcën IV, dhe mund të përdoret për eksport brenda një periudhe 6-mujore nga data kur është lëshuar.

3. Çdo leje ose certifikatë duhet të përmbajë titullin e Konventës në fjalë, emrin dhe një vulë të institucionit administrues që e ka dhënë atë dhe një numër kontrolli caktuar prej institucionit administrues.

4. Kopjet e lejeve ose certifikatave lëshuar prej institucionit administrues duhet të tregohen si kopje dhe mos të përdoren në vend të origjinalit, përveç rasteve të veçanta të përcaktuara.

5. Leje ose certifikatë e veçantë do të kërkohet për çdo ngarkesë ekzemplarësh.

6. Një institucion administrues i shtetit, që importon një ekzemplar duhet ta ndalojë dhe ruajë lejen e eksportit ose certifikatën e riekспортit dhe ndonjë leje importi korresponduese paraqitur në

përputhje me importin e atij ekzemplari.

7. Aty ku është e përshtatshme dhe e mundshme institucioni administrues duhet të fiksojë një shenjë mbi ekzemplarën për ta ndihmuar në përcaktimin e tij. Me këtë rast me “shenjë” kuptohet ndonjë stampë e paheqshme, vulë plumbi ose ndonjë gjë tjetër e përshtatshme për identifikimin e ekzemplarit, vënë në mënyrë të tillë që të pengojnë imitimin e saj prej personave të paautorizuar sa më shumë të jetë e mundur.

Neni 7

Përrjashtime dhe kushte të tjera të veçanta që lidhen me tregtinë

1. Kushtet e neneve 3, 4 dhe 5 nuk do të aplikohen për kalimin ose transportin e ekzemplarëve nëpërmjet ose në territorin e një Pale, ndërsa ekzemplarët mbesin në kontrollin doganor.

2. Kur një institucion administrues i shtetit që eksporton ose riekporton është i kënaqur që një ekzemplar është marrë përpara kushteve të Konventës në fjalë që aplikohen tek ky ekzemplar, kushtet e neneve 3, 4 dhe 5 nuk do të zbatohen tek ai ekzemplar, kur institucioni administrues lëshon një certifikatë për këtë arsye.

3. Kushtet e neneve 3, 4 dhe 5 nuk do të zbatohen për ekzemplarët që janë personale ose shtëpiake. Ky përrjashtim nuk do të zbatohet kur:

a) në rastin e një ekzemplari të specieve që përrfshihen në shtojcën I, ato janë marrë prej pronarit jashtë vendit të tij dhe janë importuar në atë shtet.

b) në rastin e ekzemplarëve të specieve të përrfshira në shtojcën II:

i) ato janë marrë prej pronarit jashtë vendit të tij dhe në një shtet ku lejohet marrja e qenieve të egra;

ii) ato janë importuar në vendin e origjinës së pronarit;

iii) shteti ku lejohet marrja e qenieve të egra kërkon lejet e eksportit përpara eksportit të këtyre ekzemplarëve, pavarësisht se institucioni administrues është i informuar që ekzemplarët janë marrë përpara se kushtet e kësaj Konvente të aplikohen tek to.

4. Ekzemplarët e specieve të kafshëve të përrfshira në shtojcën I të rritur nga njeriu për qëllime tregtimi ose të specieve të bimëve të përrfshira në shtojcën I të rritura artificialisht për qëllime tregtare, do të konsiderohen ekzemplarë të specieve të shtojcës II.

5. Kur një institucion administrues i shtetit që eksporton është njoftuar që ekzemplari i një kafshe është rritur nga njeriu ose ndonjë bimë është rritur artificialisht, ose është pjesë e kësaj kafshe ose bime, ose ka rrjedhur prej tyre, një certifikatë prej po atij institucioni administrues për këtë qëllim do të pranohet në vend të lejeve ose certifikatave të kërkuara sipas kushteve të neneve 3, 4 ose 5.

6. Kushtet e neneve 3, 4 dhe 5 nuk do të gjejnë zbatim për huatë jotregtare, dhuratat ose shkëmbimet midis shkencëtarëve ose institucioneve shkencore të njohura prej një institucioni administrues të vendit të vet, për ekzemplarët e herbareve, ata të ruajtur, tharë ose fiksuar në muze dhe materialin bimor të gjallë që mban një etiketë të lëshuar ose miratuar nga institucioni administrues.

7. Një institucion administrues i një shteti mund të ndryshojë kërkesat e neneve 3, 4 dhe 5, lejojë lëvizjen pa leje ose certifikatë të ekzemplarëve që bëjnë pjesë në kopshtet zoologjike të lëvizshme, kafshët e cirkut, ekspozitat e bimëve ose ekspozita të tjera të lëvizshme, por duke siguruar që:

a) eksportuesi ose importuesi regjistron të dhëna të plota për këta ekzemplarë tek institucioni administrues;

b) ekzemplarët janë në kategoritë e përcaktuara në paragrafin 2 ose 5 të këtij neni;

c) institucioni administrues është njoftuar që një ekzemplar i gjallë do të transportohet dhe tregohet kujdes në mënyrë që të pakësohet rreziku i plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimi i keq i tij.

Neni 8

Masat që duhen marrë nga Palët

1. Palët duhet të marrin masa për zbatimin e kushteve të kësaj Konvente dhe ndalojnë dhunimin e tregtisë së ekzemplarëve. Në këto masa do të përrfshihen:

a) ndëshkimi i tregtisë ose marrja e ekzemplarëve, ose të dyja bashkë;

- b) sigurimi i konfiskimit ose kthimit të ekzemplarit në shtetet nga u eksportua.
2. Në vijim të masave të marra sipas pikës 1 të këtij neni, një Palë, kur e shikon të arsyeshme, duhet të sigurojë një metodë për rikthim të brendshëm të shpenzimeve të shkaktuara si rezultat i konfiskimit të një ekzemplari të tregtuar në kundërshtim me masat e marra për zbatimin e kushteve të kësaj Konvente.
3. Palët duhet të garantojnë që ekzemplarët të kalojnë procedurat e kërkuara për tregtinë me një minimum vonese. Për të lehtësuar këtë kalim, një Palë duhet të caktojë portat e hyrjes dhe daljes ku ekzemplarët duhen paraqitur për qartësim. Për më tej Palët duhet të sigurojnë që të gjithë ekzemplarët e gjallë, gjatë transitit, mbajtjes ose transportit, të mbahen me kujdes për të minimizuar rrezikun e plagosjes, dëmtimit të shëndetit ose trajtimin e keq.
4. Kur një ekzemplar i gjallë është konfiskuar si rezultat i zbatimit të masave të pikës 1 të këtij neni duhet që:
- a) Ekzemplari t'i lihet institucionit administrues të shtetit që e konfiskon.
 - b) Institucioni administrues duhet që, pas konsultimit me shtetin e eksportit, të kthejë ekzemplarin në atë vend me shpenzimet e këtij vendi ose në një qendër shpëtimi, ose tjetër që institucioni administrues e gjykon të përshtatshme dhe në përputhje me kushtet e kësaj Konvente.
 - c) Institucioni administrues mund të marrë mendimin e një institucioni shkencor ose, kur e shikon të arsyeshme, të konsultohet me Sekretariatin e Konventës me qëllim lehtësimin e vendimit të marrë sipas paragrafit (b) të kësaj pike, duke përfshirë zgjedhjen e qendrës së shpëtimit ose një tjetre.
5. Qendër shpëtimi sipas pikës 4 të këtij neni kuptohet një institucion i caktuar prej një institucioni administrimi për t'u kujdesur për jetën e ekzemplarëve të gjallë, veçanërisht atyre që janë konfiskuar.
6. Çdo Palë duhet të mbajë të dhëna për tregtinë e ekzemplarëve të specieve të përfshira në shtojcat I, II dhe III që duhet të jenë:
- a) emrat dhe adresat e eksportuesve dhe importuesve;
 - b) numri dhe tipi i lejeve dhe certifikatave të dhëna; shtetet me të cilat kryhet tregtia; numri ose sasi dhe lloji i ekzemplarëve, emrat e specieve të përfshira në shtojcën I, II dhe III dhe ku është e mundur, përmasat dhe seksin e ekzemplarëve në fjalë.
7. Çdo Palë duhet të përgatisë raporte periodike për zbatimin e Konventës dhe t'i dorëzojë ato në sekretariat:
- a) një raport vjetor që përmban një përmbledhje të informacionit të përmendur në paragrafin (b) të pikës 6 të këtij neni;
 - b) një raport dyvjeçar mbi masat e marra legjislative, rregulluese dhe administrative për zbatimin e kërkesave të Konventës.
8. Informacioni i përmendur në pikën 7 të këtij neni duhet t'i jepet publikut kur është në përputhje me ligjin e Palës në fjalë.

Neni 9

Institucionet administruese dhe shkencore

1. Çdo Palë, për qëllimet e kësaj Konvente, duhet të caktojë:
- a) një ose më shumë institucione administruese kompetente për të dhënë leje ose certifikata në emër të asaj Pale;
 - b) një ose më shumë institucione shkencore.
2. Një shtet që depoziton instrumentin e ratifikimit, pranimin, aprovimit ose hyrjes duhet që në të njëjtën kohë të njoftojë qeverinë ku depozitohen dokumentet për emrin dhe adresën e institucionit administrues të caktuar për të komunikuar me Palët e tjera dhe Sekretariatin.
3. Çdo ndryshim me përcaktimet ose autorizimet sipas kushteve të këtij neni, duhet t'i komunikohet prej Palës në fjalë Sekretariatit për t'ua njoftuar dhe Palëve të tjera.
4. Një institucion administrues sipas pikës 2 të këtij neni, duhet, nëse kërkohet prej Sekretariatit ose institucionit administrues të një Pale tjetër, të komunikojë vërtetësinë e vulave, shenjave ose të tjera të përdorura për vërtetësinë e lejeve ose certifikatave.

Neni 10

Tregtia me shtetet që nuk janë Palë të Konventës

Kur eksporti ose riekspori është për në, ose importi është nga, një shtet që nuk është Palë e kësaj Konvente, mund të pranohet nga Palët një dokumentacion i krahasueshëm lëshuar nga institucionet kompetente të atij shteti dhe që janë konform me kërkesat e kësaj Konvente për lejet dhe certifikatat.

Neni 11

Konferenca e Palëve

1. Sekretariati duhet të thërrasë një takim të Palëve jo më vonë se dy vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente.

2. Pas kësaj Sekretariati duhet të organizojë takime të rregullta të paktën një herë në dy vjet, pavarësisht se Konferenca e Palëve vendos ndryshe dhe takime të jashtëzakonshme në çdo kohë me kërkesë të shkruar nga të paktën 1/3 e Palëve.

3. Në takimet, si ato të rregullta ose të jashtëzakonshme, Palët duhet të shikojnë zbatimin e Konventës dhe:

a) të përgatisin një kusht që të ndihmojnë Sekretariatin për të realizuar detyrat e tij dhe të caktojë kushtet financiare;

b) të marrin në konsideratë dhe të pranojnë ndryshime në shtojcat I dhe II sipas nenit 15;

c) të shikojnë përparimin e bërë drejt rivendosjes dhe konservimit të specieve të përfshira në shtojcat I, II dhe III;

d) të marrin dhe të shqyrtojnë raportet e paraqitura nga Sekretariati ose ndonjë Palë;

e) aty ku është e mundur, të bëjnë rekomandime për përmirësimin e efektivitetit të kësaj Konvente.

4. Në çdo takim të rregullt, Palët duhet të caktojnë kohën dhe vendin e takimit tjetër të radhës, që do të mbahet sipas kushteve të pikës 2 të këtij neni.

5. Në çdo takim Palët duhet të përcaktojnë dhe miratojnë rregullat e procedimit të një takimi.

6. Kombet e Bashkuara, agjencitë e specializuara të saj dhe Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë Atomike, dhe ndonjë shtet që nuk është Palë në këtë Konventë, mund të marrin pjesë në takimet e Palëve si vëzhgues pa të drejtë vote.

7. Një institucion ose agjenci e kualifikuar teknikisht në mbrojtjen, konservimin ose administrimin e florës dhe faunës së egër, në kategoritë e mëposhtme, dhe që ka informuar Sekretariatin për dëshirën e saj për të marrë pjesë në takimin e Palëve si vëzhgues, do të pranohet pavarësisht se të paktën 1/3 e Palëve nuk janë dakord:

a) Agjencitë ndërkombëtare ose institucionet qeveritare, ose joqeveritare dhe agjencitë e institucionet kombëtare qeveritare.

b) Agjencitë ose organizatat kombëtare joqeveritare, të cilat janë miratuar të tilla nga shteti ku ato ndodhen.

Sapo të pranohen, këta vëzhgues do të kenë të drejtën të marrin pjesë në takime, por pa të drejtë vote.

Neni 12

Sekretariati

1. Pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, duhet të krijohet Sekretariati nga Drejtori Ekzekutiv i Organizatës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin (UNEP). Nëse shikohet e nevojshme dhe e domosdoshme Sekretariati mund të ndihmohet nga agjenci dhe institucione ndërqeveritare ose joqeveritare kombëtare ose ndërkombëtare të kualifikuara teknikisht në mbrojtjen, konservimin dhe administrimin e florës dhe faunës së egër.

2. Detyrat e Sekretariatit do të jenë:

a) të përgatisë dhe organizojë takimet e Palëve;

b) të plotësojë funksionet e caktuara atij sipas kushteve të neneve 15 dhe 16 të kësaj Konvente;

c) të ndërmarrë studime shkencore dhe teknike në përputhje me programet e miratuara nga konferenca e Palëve, që do të ndihmojnë në zbatimin e kësaj Konvente, duke përfshirë studime lidhur me standardet për përgatitjen dhe transportin e përshtatshëm të ekzemplarëve të gjallë dhe mënyrat për identifikimin e tyre;

d) të studiojë raportet e Palëve dhe të kërkojë prej tyre informacione të mëtejshme, kur e shikon të nevojshme, për të siguruar zbatimin e kësaj Konvente;

e) të tërheqë vëmendjen e Palëve për çështje që lidhen me qëllimet e kësaj Konvente;

f) të publikojë periodikisht dhe të shpërndajë tek Palët njoftime aktuale për shtojcat I, II dhe III së bashku me ndonjë informacion që do të lehtësojë përcaktimin e ekzemplarëve të specieve të përfshira në këto shtojca;

g) të përgatisë raporte vjetore për Palët, për punën e tij dhe për zbatimin e kësaj Konvente dhe të tjera që mund të kërkojnë nga takimet e Palëve;

h) të rekomandojë masa për plotësimin e qëllimeve dhe kushteve të kësaj Konvente, duke përfshirë shkëmbimin e informacionit me natyrë shkencore ose teknike;

i) të kryejë funksione që mund t'i caktohen nga Palët.

Neni 13

Masat ndërkombëtare

1. Në rastet kur Sekretariati sipas, informacionit të marrë, di që ndonjë specie përfshirë në shtojcat I ose II është dëmtuar në mënyrë të pakthyeshme prej tregtisë së ekzemplarëve të saj ose që kërkesat e kësaj Konvente nuk janë zbatuar efektshëm, duhet ta komunikojë këtë informacion tek institucioni administrues i caktuar prej Palës ose palëve në fjalë.

2. Kur një Palë merr informacion siç thuhet në pikën 1 të këtij neni, ajo duhet që menjëherë të informojë Sekretariatin për faktorët përkatës të deriatëhershëm siç e lejojnë ligjet dhe, kur është e mundur, të propozojë veprime për korrigjim. Kur një Palë përcakton që kërkesa është e pranueshme, kjo duhet të kryhet nga një ose më shumë persona të autorizuar nga Pala.

3. Informacioni i siguruar nga Pala ose rezultuar prej një kërkesë siç thuhet në pikën 2 të këtij neni duhet të shqyrtohet nga Konferenca e ardhshme e Palëve, e cila mund të bëjë rekomandime ku ajo e sheh të përshtatshme.

Neni 14

Ndikimi mbi legjislacionin kombëtar dhe konventat ndërkombëtare

1. Kërkesat e kësaj Konvente ndikojnë në të drejtën e Palëve të marrin:

a) masa strikte kombëtare lidhur me kushtet për tregti, marrje, zotërim ose transport të ekzemplarëve të specieve që përfshihen në shtojcat I, II dhe III ose ndalimin total të tyre;

b) masa kombëtare që kufizojnë ose ndalojnë tregtinë, marrjen, zotërimin ose transportin e specieve që nuk përfshihen në shtojcat I, II ose III.

2. Kushtet e kësaj Konvente do të ndikojnë në kërkesat e ndonjë mase kombëtare ose detyrimet e Palëve që rrjedhin prej ndonjë traktati, konvente ose marrëveshjeje ndërkombëtare që lidhet me aspekte të tjera të tregtisë, marrjes, zotërimit ose transportit të ekzemplarëve që janë në fuqi ose mund të hyjnë për një Palë, duke përfshirë dhe ndonjë masë që lidhet me doganat, shëndetin publik, veterinarinë ose karantinën e bimëve.

3. Kërkesat e kësaj Konvente, do të ndikojnë në kërkesat e, ose detyrimet që rrjedhin prej ndonjë traktati, konvente ose marrëveshjeje ndërkombëtare të arritur ose që mund të arrihet ndërmjet shteteve, që krijojnë një bashkim ose marrëveshje rajonale tregtare për të vendosur ose ruajtur një kontroll të vazhdueshëm doganor të jashtëm dhe të lëvizshëm ndërmjet palëve, që lidhen me tregti ndërmjet shteteve anëtare të atij bashkimi ose marrëveshjeje.

4. Një shtet Palë në këtë Konventë, që është Palë dhe në ndonjë traktat, konventë ose marrëveshje ndërkombëtare tjetër që janë në fuqi në kohën që ka hyrë në fuqi kjo Konventë dhe me kushtet e saj mbrojtja u sigurohet specieve detare të përfshira në shtojcën II, duhet të lirohet nga detyrimet e imponuara mbi të prej kërkesave të kësaj Konvente në lidhje me tregtinë e ekzemplarëve të specieve që bëjnë pjesë në shtojcën II, që janë marrë prej anijeve të regjistruara në atë shtet dhe në përputhje me kërkesat e një tjetër traktati, konvente ose marrëveshjeje ndërkombëtare.

5. Pavarësisht nga kërkesat e neneve 3, 4 dhe 5, eksporti i një ekzemplari të marrë në përputhje me pikën 4 të këtij neni, do të bëhet vetëm me një certifikatë nga një institucion administrues i shtetit ku hyhet për arsye që ekzemplari është marrë në përputhje me kërkesat e një traktati, konvente ose marrëveshjeje ndërkombëtare tjetër në fjalë.

6. Asgjë në Konventën në fjalë nuk do të paragjykojë zbatimin dhe ecurinë e ligjit mbi detin prej Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi ligjin e detit në përputhje me rezolutën 2750 C(XXV) të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara dhe as pretendimet aktuale ose të ardhshme dhe pikëpamjet ligjore të ndonjë shteti, lidhur me ligjin e detit dhe natyrën e shtrirjen bregdetare e tokësore nën juridiksionin e shtetit.

Neni 15

Ndryshimet për shtojcat I dhe II

1. Kërkesat që vijojnë duhet të zbatohen në lidhje me ndryshimet e shtojcave I dhe II në konferencat e Palëve:

a) Çdo Palë mund të propozojë një ndryshim për shtojcën I ose II për t'u shqyrtuar në takimin e ardhshëm të Palëve. Teksti i ndryshimit të propozuar duhet t'i komunikohet Sekretariatit të paktën 150 ditë përpara takimit. Sekretariati duhet të konsultohet me Palët e tjera dhe organizmat e interesuara mbi ndryshimin në përputhje me kërkesat e paragrafëve (b) dhe (c) të pikës 2 të këtij neni dhe duhet të komunikojë përgjigjen tek të gjitha Palët jo më vonë se 30 ditë përpara takimit.

b) Ndryshimet duhet të pranohen nga 2/3 e Palëve që janë prezente dhe që votojnë. Për këtë qëllim "Palë prezente dhe që votojnë" kuptohen Palët që ndodhen dhe japin një votë pro ose kundër. Palët që refuzojnë votimin nuk do të numërohen në 2/3 e nevojshme për miratimin e një ndryshimi.

c) Ndryshimet e miratuara në takim duhet të hyjnë në fuqi 90 ditë pas takimit për të gjitha Palët, përveç atyre që paraqesin rezerva në përputhje me pikën 3 të këtij neni.

2. Kërkesat e mëposhtme do të zbatohen në përputhje me ndryshimet e shtojcave I dhe II midis takimeve të Konferencës së Palëve:

a) Çdo Palë mund të propozojë ndryshimet për shtojcat I ose II për t'u marrë në shqyrtim nga takimet me procedura postare të përcaktuara në këtë pikë.

b) Për speciet detare, Sekretariati duhet që, pas marrjes së tekstit për ndryshimin e propozuar, t'ua komunikojë menjëherë Palëve. Ai duhet gjithashtu të konsultohet me organizmat ndërqeveritare që kanë përgjegjësi në lidhje me këto specie, veçanërisht për marrjen e të dhënave shkencore prej tyre që do të jenë në gjendje të kenë dhe sigurojnë koordinimin për masat konservuese të zbatuara prej këtyre organizmave. Sekretariati duhet të komunikojë pikëpamjet e shprehura dhe të dhënat e siguruar nga këto institucione dhe përfundimet e rekomandimet e tij sa më parë për Palët.

c) Për speciet jodetare, Sekretariati duhet që, pas marrjes së tekstit të ndryshimit të propozuar, të komunikojë menjëherë tek Palët dhe, sa më shpejt të jetë e mundur, rekomandimet e tij.

d) Çdo Palë duhet që, brenda 60 ditëve pas datës kur Sekretariati komunikoi rekomandimet e tij tek Palët, sipas paragrafit (b) ose (c) të kësaj pike, të transmetojë tek Sekretariati komentet mbi ndryshimin e propozuar së bashku me ndonjë të dhënë e informacion shkencor përkatës.

e) Sekretariati duhet të komunikojë përgjigjet e marra së bashku me rekomandimet e tij tek Palët sa më parë.

f) Nëse nuk ka kundërshtime për ndryshimin e propozuar prej Sekretariatit brenda 30 ditëve nga data kur përgjigjet dhe rekomandimet janë komunikuar, sipas kërkesave të paragrafit (e) të kësaj pike, ndryshimi do të hyjë në fuqi 90 ditë më vonë për të gjitha Palët, përveç atyre që paraqesin rezervë sipas pikës 3 të këtij neni.

g) Nëse Sekretariati ka marrë ndonjë kundërshtim prej ndonjë Palë, ndryshimi i propozuar duhet të dorëzohet me postë në përputhje me kërkesat e paragrafëve (h), (i) dhe (j) të kësaj pike.

h) Sekretariati duhet të njoftojë Palët nga të cilat janë marrë kundërshtimet.

i) Pavarësisht se Sekretariati merr votat për, kundër ose në mungesë prej e të paktën gjysmës së Palëve brenda 60 ditëve prej datës së njoftimit, sipas paragrafit (h) të kësaj pike, ndryshimi i propozuar duhet të njoftohet në takimin tjetër të Palëve për shqyrtim të mëtejshëm.

j) Duke siguruar që votat janë marrë prej gjysmës së Palëve, ndryshimi duhet të miratohet prej 2/3 të Palëve duke dhënë një votë miratuese ose negative.

k) Sekretariati duhet të njoftojë të gjitha Palët për rezultatin e votimit.

1) Nëse ndryshimi i propozuar miratohet, ai duhet të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së njoftuar nga Sekretariati që ai u pranua nga të gjitha Palët, përveç atyre që bëjnë një rezervim sipas pikës 3 të këtij neni.

Gjatë periudhës 90 ditëshe kërkuar për paragrafin (c) të pikës 1 ose paragrafin (1) të pikës 2 të këtij neni, çdo Palë mundet që duke njoftuar me shkrim Qeverinë Depozituese të paraqesë një rezervë lidhur me ndryshimin. Derisa rezerva të tërhiqet, Pala duhet të trajtohet si një shtet dhe jo si Palë në Konventën në fjalë në përputhje me tregtinë e specieve në fjalë.

Neni 16

Shtojca III dhe ndryshimet më tej

1. Çdo Palë duhet që në çdo kohë të dorëzojë tek Sekretariati një listë të specieve që ajo i përcakton si objekt të rregullores brenda juridiksionit të saj për qëllimin e përmendur në pikën 3 të nenit 2. Shtojca III duhet të përmbajë emrat e Palëve që njoftojnë speciet për t'u përfshirë këtu, emrat shkencore të tyre dhe pjesët ose derivatet e bimëve ose kafshëve në fjalë, që janë specifikuar në lidhje me speciet për kërkesat e paragrafit (b) të nenit 1.

2. Çdo listë dorëzuar sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni duhet t'u komunikohet Palëve prej Sekretariatit sa më parë pas marrjes së tyre. Lista do të hyjë në zbatim si pjesë e shtojcës III, 90 ditë pas datës kur është komunikuar. Në çdo kohë pas komunikimit të kësaj liste, çdo Palë duhet që nëpërmjet njoftimit të shkruar tek Qeveria Depozituese, të dorëzojë një rezervë në lidhje me ndonjë specie ose pjesë ose derivat dhe derisa kjo rezervë të hiqet, shteti do të trajtohet si shtet dhe jo si Palë e kësaj Konvente në lidhje me tregtinë e specieve ose pjesëve apo derivateve të tyre.

3. Një Palë, që ka njoftuar një specie për t'u përfshirë në shtojcën III, mund ta tërheqë njoftimin në çdo kohë duke njoftuar Sekretariatit, i cili duhet të komunikojë tërheqjen tek të gjitha Palët. Tërheqja do të zbatohet 30 ditë pas datës së komunikimit.

4. Çdo Palë, që dorëzon një listë sipas kërkesave të pikës 1 të këtij neni, duhet të dorëzojë tek Sekretariati një kopje të të gjitha ligjeve e rregulloreve të vendit të aplikueshme për mbrojtjen e këtyre specieve, së bashku me interpretimet që Palës mund t'i duken të përshtatshme ose që i kërkon Sekretariati. Pala duhet që, për aq kohë sa specia në fjalë përfshihet në shtojcën III, të dorëzojë ndonjë ndryshim të këtyre ligjeve e rregulloreve ose ndonjë interpretim sikurse janë miratuar.

Neni 17

Ndryshimi i Konventës

1. Një takim i jashtëzakonshëm i Konferencës së Palëve duhet të thërritet nga Sekretariati me kërkesë të shkruar prej të paktën 1/3 së Palëve për të shqyrtuar dhe miratuar ndryshimet për Konventën në fjalë. Këto ndryshime duhet të miratohen prej 2/3 së Palëve që janë prezente dhe votojnë. Për këtë qëllim "Palë prezente dhe që votojnë" kuptohen Palët që marrin pjesë dhe japin një votë pozitive ose negative në takim. Palët që abstenojnë votimin nuk do të numërohen në 2/3 e kërkuara për miratimin e një ndryshimi.

2. Teksti i një ndryshimi të propozuar duhet të komunikohet prej Sekretariatit tek të gjitha Palët të paktën 90 ditë përpara takimit.

3. Një ndryshim do të hyjë në fuqi për Palët që e kanë pranuar atë 60 ditë pasi 2/3 e Palëve kanë depozituar një instrument të pranimi të ndryshimit të Qeveria Depozituese. Për më tej, ndryshimi do të hyjë në fuqi për ndonjë Palë tjetër 60 ditë pasi kjo Palë depoziton instrumentin e saj për pranimin e ndryshimit të bërë.

Neni 18

Vendimi i kundërshtimeve

1. Çdo kundërshtim që mund të ngrihet midis dy ose më shumë Palëve për interpretimin ose aplikimin e kërkesave të kësaj Konvente, do të bëhet objekt i bisedimeve midis Palëve të lidhura me këtë kundërshtim.

2. Nëse kundërshtimi nuk mund të zgjidhet, sipas pikës 1 të këtij neni, Palët duhet që, me pëlqimin e ndërsjellë, të paraqesin kundërshtimin në gjyq, veçanërisht te Trupi i Përhershëm Gjykses

në Hagë dhe Palët që e paraqesin atë duhet t'i përmbahen vendimit të gjyqit.

Neni 19
Nënshkrimi

Kjo Konventë duhet të hapet për nënshkrim në Uashington deri më 30 prill 1973 dhe më pas në Bernë deri më 31 dhjetor 1974.

Neni 20
Ratifikimi, pranimi, aprovimi

Kjo Konventë do të jetë objekt i ratifikimit, pranimit ose aprovimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit ose aprovimit duhet të depozitohen te Qeveria e Konfederatës Zvicerane, që do të jetë Qeveria Depozituese.

Neni 21
Hyrja

Kjo Konventë do të jetë e hapur me afat të pacaktuar për hyrje. Instrumentet e hyrjes duhet të depozitohen te Qeveria Depozituese.

Neni 22
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi 90 ditë pas datës së depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes te Qeveria Depozituese.

2. Për çdo shtet që ratifikon, pranon ose aprovon këtë Konventë ose hyn pas depozitimit të instrumentit të dhjetë të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, kjo Konventë duhet të hyjë në fuqi 90 ditë pas depozitimit prej këtij shteti të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes.

Neni 23
Rezervat

1. Kërkesat e kësaj Konvente nuk do të jenë objekt i rezervave të përgjithshme. Rezerva specifike mund të pranohen në përputhje me kërkesat e këtij neni dhe neneve 15 dhe 16.

2. Çdo shtet mundet që, në kohën e depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, të paraqesë një rezervë specifike për:

a) një specie të përfshirë në shtojcën I, II ose III;

b) një pjesë ose derivat specifikuar në lidhje me një specie të përfshirë në shtojcën III.

3. Derisa një Palë të tërheqë rezervën e saj të pranuar sipas kërkesave të këtij neni, ajo do të trajtohet si shtet dhe jo si Palë në këtë Konventë në përputhje me tregtinë e specieve të veçanta ose pjesëve ose derivateve të specifikuara në këtë rezervë.

Neni 24
Denoncimi

Çdo Palë mund ta denoncojë në çdo kohë këtë Konventë me një njoftim të shkruar te Qeveria Depozituese. Denoncimi do të bëhet i efektshëm 12 muaj, pasi Qeveria Depozituese ka marrë njoftimin.

Neni 25
Depozitimi

1. Origjinali i kësaj Konvente, në gjuhët kineze, angleze, franceze, ruse dhe spanjolle, ku çdo version duhet të jetë i njëjtë, duhet të depozitohet te Qeveria Depozituese, e cila duhet të transmetojë

kopje të vulosura tek të gjitha shtetet që e kanë nënshkruar atë ose depozituar instrumentet e pranimit.

2. Qeveria Depozituese duhet të informojë të gjitha shtetet nënshkruese që hyjnë dhe Sekretariatit për firmosjen, depozitim të instrumenteve të ratifikimit, pranimit, aprovimit ose hyrjes, hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, ndryshimeve, dorëzimit dhe tërheqjes së rezervave dhe njoftimeve të denoncimit.

3. Sapo kjo Konventë të hyjë në veprim, një kopje e vulosur duhet të transmetohet prej Qeverisë Depozituese te Sekretariati i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe publikim në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Në praninë e tyre përfaqësuesit nënshkrues, të caktuar për këtë qëllim, nënshkruan këtë Konventë.

Bërë në Uashington, më 3 mars 1973.

Shtojcat I dhe II

Janë miratuar nga Konferenca e Palëve dhe hyjnë në fuqi më 16 shkurt 1995.

Shpjegim

1. Speciet që përfshihen në këto shtojca shpjegohen me:

a) emrin e species;

b) të gjitha speciet që përfshihen në një takson më të lartë ose në një pjesë të caktuar.

2. Shkurtimi “spp.” është përdorur për të treguar të gjitha speciet e një taksoni më të lartë.

3. Përcaktime të tjera për taksonet më të larta se speciet janë bërë për arsye informimi ose klasifikimi.

4. Shkurtimi “p.e.” është përdorur për të treguar speciet që mund të zhduken.

5. Një (*) vendosur tek emri i një specieje ose taksoni më të lartë tregon që një ose më shumë popullata të ndara gjeografikisht, nënspeciet ose ekzemplarët e këtyre specieve ose taksoni janë përfshirë në shtojcën I dhe janë përjashtuar nga shtojca II.

6. Dy yje (**) vendosur tek emri i një specieje ose taksoni më të lartë tregon që një ose më shumë popullata të ndara gjeografikisht, nënspeciet ose ekzemplarët e këtyre specieve ose taksoni janë përfshirë në shtojcën I dhe janë përjashtuar nga shtojca II.

7. Simboli (-) dhe një numër pas tij vendosur tek emri i një specieje ose taksoni më të lartë tregon që popullatat e ndara gjeografikisht të përcaktuara, speciet, grupet e specieve ose familjet e tyre ose taksonet janë përjashtuar nga shtojca në fjalë, si vijon:

- 101 Popullata e Groenlandës Perëndimore
- 102 Popullatat e Butanit, Indisë, Nepalit dhe Pakistanit
- 103 Popullata e Australisë
- 104 Popullata e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
- 105 Kili: pjesë e popullatës së Provincës Parinakota, Rajoni i Tarapakës – Peru: e gjithë popullata
- 106 Popullatat e Afganistanit, Butanit, Indisë, Maynmarit, Nepalit dhe Pakistanit.
- 107 Cathartidae
- 108 Melopsittacus undulatus, Nymphicus hollandicus dhe Psittacula krameri
- 109 Popullata e Ekuadorit, objekt i kuotave zero të eksportit në 1995 dhe 1996 dhe kuotave vjetore të eksportit të miratuara nga Sekretariati i CITES dhe grupi i specialistëve për Krokodilin i IUCN/SSC
- 110 Popullatat e Botsvanës, Etiopisë, Kenias, Malavisë, Mozambikut, Afrikës së Jugut, Republikës së Bashkuar të Tanzanisë, Zambias dhe Zimbabves dhe popullatat e vendeve në vijim objekt i kuotave të përcaktuara vjetore të eksportit:

	1995	1996	1997
Madagaskari	4.700	5.200	5.200
(ekzemplarët e fermave:	4.500	5.000	5.000
Ekzemplarët e egër të zhurmshëm:	200	200	200
Uganda	2.500	2.500	2.500

Veças nga ekzemplarët e fermave, Republika e Bashkuar e Tanzanisë do të autorizojë eksportin e jo më shumë se 1100 ekzemplarëve të egër (përfshirë 100 trofe gjahu) në 1995 dhe 1996 dhe një numër që duhet miratuar në 1997 nga Sekretariati i CITES dhe grupi i specialistëve për krokodilin IUCN /SSC.

- 111 Popullatat e Australisë, Indonezisë dhe Papua Guinesë së Re
 - 112 Popullata e Kilit
 - 113 Të gjitha speciet që nuk janë të shijshme
 - 114 Aloe vera, e emërtuar dhe Aloe barbadensis
- 8.Simboli (+) ndjekur prej një numri e vendosur tek emri i një speciejë ose taksoni më të lartë tregon që vetëm popullatat e ndara të caktuara gjeografikisht, nënspeciet ose ekzemplarët e atyre specieve ose taksonëve janë përfshirë në shtojcën në fjalë, si vijon:
- +201 Popullatat e Butanit, Indisë, Nepalit dhe Pakistanit
 - +202 Popullatat e Butanit, Kinës, Meksikës dhe Mongolisë
 - +203 Popullatat e Kamerunit dhe Nigerisë
 - +204 Popullata e Azisë
 - +205 Popullata e Amerikës Qendrore dhe Veriore
 - +206 Popullatat e Bangladeshit, Indisë dhe Tailandës
 - +207 Popullata e Indisë
 - +208 Popullata e Australisë
 - +209 Popullata e Afrikës së Jugut
 - +210 - Kili: pjesë e popullatës së Provincës Parinakota, Rajonit të Tarapakës-Peru: e gjithë popullata
 - +211 Popullatat e Afganistanit, Butanit, Indisë. Maynmarit, Nepalit dhe Pakistanit
 - +212 Popullatat e Meksikës
 - +213 Popullatat e Algjerisë, Burkina Fasos, Kamerunit, Republikës së Afrikës Qendrore, Cadit, Malit, Mauritanisë, Marokut, Nigerisë, Senegalit dhe Sudanit
 - +214 Popullata e Seishelleve
 - +215 Popullata e Europës, përveç zonave që më parë i takonin ish-Bashkimit Sovjetik.
 - +216 Të gjitha speciet e Zelandës së Re
 - +217 Popullata e Kilit

9. Simboli (=) ndjekur nga një numër e vendosur pranë emrit të një speciejë ose një taksoni më të lartë tregon që emri i atyre specieve ose taksoni duhet të interpretohet si vijon:

- =301 Përmendur dhe si Phalanger maculatus
- =302 Përfshin familjen Tupaiidae
- =303 Më parë përfshirë në familjen Lemuridae
- =304 Më parë njohur si nënspecie e Callithrix jacchus
- =305 Përfshin sinonimin gjinor Leontideus
- =306 Më parë përfshirë në specien Saguimis oedipus
- =307 Më parë njohur si Alouatta (villosa)
- =308 Përfshin sinonimin Ceropithecus rolaway
- =309 Më parë përfshirë në gjininë Papio
- =310 Përfshin sinonimin gjinor Simias
- =311 Përfshin sinonimin Colobus badius kirkii
- =312 Përfshin sinonimin Colobus badius rufomitatus
- =313 Përfshin sinonimin gjinor Rhinopithecus
- =314 Gjithashtu njihet si Presbytis enetellus
- =315 Gjithashtu njohur si Presbytis geei dhe Semnopithecus geei
- =316 Gjithashtu njohur si Presbytis pileata dhe Semnopithecus pileatus
- =317 Përfshin sinonimet Bradypus boliviensis dhe Bradypus griseus
- =318 Përfshin sinonimin Priodontes giganteus
- =319 Përfshin sinonimin Physeter macrocephalus

- =320 Përfshin sinonimin *Eschrishtius glaucus*
- =321 Më parë përfshin në gjininë *Balaena*
- =322 Më parë përfshirë në gjininë *Dusicyon*
- =323 Përfshin sinonimin *Dusicyon fulvipes*
- =324 Përfshin sinonimin gjinor *Fennecus*
- =325 Gjithashtu njohur si *Selenarctos thibetanus*
- =326 Gjithashtu njohur si *Aonyx microdon* ose *Paraonyx microdon*
- =327 Më parë përfshirë në gjininë *Lutra*
- =328 Më parë përfshirë në gjininë *Lutra*; përfshin sinonimet *Lutra annectens*, *Lutra enudris*, *Lutra incarum* dhe *Lutra platensis*
- =329 Përfshin sinonimin *Eupleres major*
- =330 Gjithashtu njohur si *Hyaena brunnea*
- =331 Gjithashtu njohur si *Felis caracal* dhe *Lynx caracal*
- =332 Më parë përfshin në gjininë *Felis*
- =333 Gjithashtu njohur si *Felis pardina* ose *Felis lynx pardina*
- =334 Më parë përfshirë në gjininë *Panthera*
- =335 Gjithashtu njohur si *Equus asinus*
- =336 Më parë përfshirë në specien *Aquus hemionus*
- =337 Gjithashtu njohur si *Equus caballus przewalskii*
- =338 Gjithashtu njohur si *Cheoeropsis liberiensis*
- =339 Gjithashtu njohur si *Cervus porcinus annamiticus*
- =340 Gjithashtu njohur si *Cervus porcinus calamianensis*
- =341 Gjithashtu njohur si *Cervus porcinus kuhlii*
- =342 Gjithashtu njohur si *Cervus dama mesopotamicus*
- =343 Përfshin sinonimin *Bos frontalis*
- =344 Përfshin sinonimin *Bos grunniens*
- =345 Përfshin sinonimin gjinor *Novibos*
- =346 Përfshin sinonimin gjinor *Anoa*
- =347 Gjithashtu njohur si *Damaliscus dorcas dorcas*
- =348 Më parë përfshirë në speciet *Naemorhedus goral*
- =349 Gjithashtu njohur si *Capricornis sumatraensis*
- =350 Përfshin sinonimin *Oryx tao*
- =351 Përfshin sinonimin *Ovis aries ophion*
- =352 Gjithashtu njohur si *Rupicapra rupicapra ornata*
- =353 Gjithashtu njohur si *Pterocnemia pennata*
- =354 Gjithashtu njohur si *Sula abbotti*
- =355 Gjithashtu njohur si *Ciconia ciconia boyciana*
- =356 Përfshin sinonimet *Anas chlorotis* dhe *Anas nesiotis*
- =357 Gjithashtu njohur si *Ana platyrhynchos laysanensis*
- =358 Ndoshta një hibrid midis *Anas platyrhynchos* dhe *Anas superciliose*
- =359 Gjithashtu njohur si *Aquila heliaca adalberti*
- =360 Gjithashtu njohur si *Chondrohierax wilsonii*
- =361 Gjithashtu njohur si *Falco peregrinus* *babylonuc* dhe *Falco peregrinus pelegrinoides*
- =362 Gjithashtu njohur si *Crax mitu mitu*
- =363 Më parë përfshirë në gjininë *Aburria*
- =364 Më parë përfshirë në speciet *Crossoptilon crossoptilon*
- =365 Më parë përfshirë në speciet *Polyplectron malacense*
- =366 Përfshin sinonimin *Rheinardia nigrescens*
- =367 Gjithashtu njohur si *Tricholimnas sylvestris*
- =368 Gjithashtu njohur si *Choriotis nigreps*
- =369 Gjithashtu njohur si *Houbaropsis bengalensis*
- =370 Gjithashtu njohur si *Amazona dufresniana rhodocorytha*
- =371 Shpesh përmend me një emër të pasaktë *Ara caninde*
- =372 Gjithashtu njohur si *Cyanoramphus novaezelandiae cookii*

- =373 Gjithashtu njohur si *Opopsitta diophthalma coxeni*
- =374 Gjithashtu njohur si *Pezoporus occidentalis*
- =375 Më parë përfshirë në specien *Psephotus Chrysopterygius*
- =376 Gjithashtu njohur si *Psittacula krameri echo*
- =377 Më parë përfshirë në gjininë *Gallirex*; gjithashtu njohur is *Tauraco porphyreolophus*
- =378 Gjithashtu njohur si *Otus gurneyi*
- =379 Gjithashtu njohur si *Ninox novaeseelandiae royana*
- =380 Më parë përfshirë në gjininë *Glaucis*
- =381 Përfshin sinonimin gjinor *Ptilolaemus*
- =382 Më parë përfshirë në gjininë *Rhinoplax*
- =383 Gjithashtu njohur si *Pitta brachyura nympha*
- =384 Gjithashtu njohur si *Muscicapa ruecki* ose *Niltava ruecki*
- =385 Gjithashtu njohur si *Dasyomis brachypterus longirostris*
- =386 Gjithashtu njohur si *Meliphaga cassidix*
- =387 Më parë përfshirë në gjininë *Spinus*
- =388 Më parë njohur si *Kachuga tecta tecta*
- =389 Përfshin sinonimet gjinore *Nicoria* dhe *Geoemyda* (pjesë të saj)
- =390 Gjithashtu njohur si *Geochelone elephantopus*; gjithashtu njohur në gjininë *Testudo*
- =391 Gjithashtu njohur në gjininë *Testudo*
- =392 Gjithashtu njohur në gjininë *Aspideretes*
- =393 Më parë përfshirë në *Podacnemis* spp.
- =394 Përfshin *Alligatoridae*, *Crocodylidae* dhe *Gavialidae*
- =395 Gjithashtu njohur si *Crocodylus mindorensis*
- =396 Më parë përfshirë tek *Chamaeleo* spp.
- =397 Gjithashtu njohur si *Constrictor constrictor occidentalis*
- =398 Përfshin sinonimin *Python molurus pimbura*
- =399 Përfshin sinonimin *Pseudoboa cloelia*
- =400 Gjithashtu njohur si *Hydrodynastes gigas*
- =401 Përfshin sinonimin gjinor *Megalobatrachus*
- =402 Sensus D'Abrera
- =403 Gjithashtu njohur si *Conchodromus dromas*
- =404 Gjithashtu njohur në gjininë *Dysnomia* dhe *Plagiola*
- =405 Përfshin sinonimin gjinor *Proptera*
- =406 Gjithashtu njohur në gjininë *Caranculina*
- =407 Gjithashtu njohur si *Megalonaias nickliniana*
- =408 Gjithashtu njohur si *Cyrtonaias tampicoensis tecomatensis* dhe *Lampsilis tampicoensis tecomatensis*
- =409 Përfshin sinonimin gjinor *Micromya*
- =410 Përfshin sinonimin gjinor *Papuina*
- =411 Përfshin vetëm familjen *Helioporidae* me një specie *Heliopora coerulea*
- =412 Gjithashtu njohur si *Podophyllum emodi* dhe *Sinopodophyllum hexandrum*
- =413 Gjithashtu njohur në gjininë *Echinocactus*
- =414 Gjithashtu njohur si *Lobeira macdougallii* ose *Nopalxochia macdougallii*
- =415 Gjithashtu njohur si *Echinocereus lindsayi*
- =416 Gjithashtu njohur si *Wilcoxia schmollii*
- =417 Gjithashtu njohur në gjininë *Coryphantha*
- =418 Gjithashtu njohur si *Solisia pectinata*
- =419 Gjithashtu njohur si *Backebergia militaris*
- =420 Gjithashtu njohur në gjininë *Toumeyia*
- =421 Përfshin sinonimin *Ansistrocactus tobuschii*
- =422 Gjithashtu njohur në gjininë *Neolloydia* ose në gjininë *Echinomastus*
- =423 Gjithashtu njohur në gjininë *Toumeyia* ose në gjininë *Pediocactus*
- =424 Gjithashtu njohur si në gjininë *Neolloydia*
- =425 Gjithashtu njohur si *Saussurea lappa*
- =426 Përfshin *Euphorbia cylindrifolia* ssp. *tuberifera*

- =427 Gjithashtu njohur si *Euphorbia capsaintemariensis* var. *tulearensis*
- =428 Gjithashtu njohur si *Engelhardia pterocarpa*
- =429 Përfshin *Aloe compressa* var. *rugosquamosa* dhe *Aloe compressa* var. *schistophila*.
- =430 Përfshin *Aloe haworthioides* var. *aurantiaca*
- =431 Përfshin *Aloe laeta* var. *maniaensis*
- =432 Përfshin familjet *Apostasiaceae* dhe *Cypripediaceae* për nënfamiljet *Apostasioideae* dhe *Cypripedioideae*
- =433 Gjithashtu njohur si *Sarracenia rubra alabamensis*
- =434 Gjithashtu njohur si *Sarracenia rubra jonesii*
- =435 Përfshin sinonimin *Stangeria paradoxa*
- =436 Gjithashtu njohur si *Toxus baccata* ssp. *wallichiana*
- =437 Përfshin sinonimin *Welwitschia bainesii*

10. Simboli (o) ndjekur nga një numër vendosur pranë emrit të një speciejë ose një taksoni më të lartë do të shpjegohet si vijon:

- 0501 Ekzemplarët shtëpiakë nuk janë objekt i kërkesave të Konventës
- 0502 Kuotat vjetore të eksportit për ekzemplarët e gjallë dhe trofetë e gjahut janë si vijon:
 - Botsvana 5
 - Namibia 150
 - Simbabve 50
- Tregtia e këtyre ekzemplarëve është objekt i kërkesave të nenit 3 të kësaj Konvente.
- 0503 Për qëllim të veçantë për lejimin e tregtisë ndërkombëtare për kafshët e gjalla në destinacione të përshtatshme dhe të pranueshme dhe trofetë e gjahut
- 0504 Për qëllim të veçantë për lejimin e tregtisë ndërkombëtare të leshit të qethur prej “vicuñas” të popullatave të përfshira në shtojcën II (shiko+210) dhe në inventarin aktual në Peru të 3249 kg lesh dhe veshje dhe të tjera. Ana e kundërt e veshjes duhet të mbajë shenjën e miratuar prej shteteve të lidhura me specien, që janë nënshkruese të “Convenio para la Conservacion y Manejo de la Vicuna” dhe në anët fjalët “Vicunandes – Chile” ose “Vicunandes-Peru”, varet nga vendi i origjinës.
- 0505 Fosilet nuk janë objekt i kushteve të Konventës
- 0506 Eksporti i bimëve të rritura të species. *Pachypodium brevicaule* nuk është i lejuar deri në takimin e 10 të Palëve.
- 0507 Kulturat që rriten me farë ose me inde të marra in vitro, në ambient të ngurtë ose të lëngshëm, transportuar në mbajtësa sterile nuk janë objekt i kërkesave të Konventës.

11. Në përputhje me nenin 1 paragrafi b nënparagrafi (iii) të Konventës, simboli (#) ndjekur prej një numri, vendosur pranë emrit të një speciejë ose taksoni më të lartë përfshirë në shtojcën II, përcakton pjesë ose derivate, që janë specifikuar për qëllime të Konventës si vijon:

- # 1 Përcakton të gjitha pjesët dhe derivatet, përveç:
 - a) farat, sporet dhe pjalmën;
 - b) kulturat që rriten me farë ose me inde të marra in vitro, në ambient të ngurtë ose të lëngshëm, transportuar në mbajtëse sterile.
- # 2 Përcakton të gjitha pjesët dhe derivatet, përveç:
 - a) farave dhe pjalmët;
 - b) kulturave që rriten me farë ose me inde të marra in vitro, në ambient të ngurtë ose të lëngshëm, transportuar në mbajtëse sterile;
 - c) prejardhjet kimike.
- # 3 Përcakton rrënjët dhe pjesët e dukshme
- # 4 Përcakton të gjitha pjesët dhe prejardhjet, përveç:
 - a) farave dhe pjalmët;
 - b) kulturave që rriten me farë ose me inde të marra in vitro, në ambient të ngurtë ose të lëngshëm, transportuar në mbajtëse sterile;
 - c) frutat dhe pjesë e prejardhje të bimëve natyrale ose artificiale të shumëzuara;

- d) bashkime kërcelli të ndara (mbushje) dhe pjesë e prejardhje të bimëve të shumëzuara natyrisht ose artificialisht të gjinisë Opuntia nëngjinia Opuntia.
- # 5 Përcakton trupat për sharrim, drurët e sharruar dhe rimesot.
- # 6 Përcakton trupat, ashklat e drurit dhe materialin e thyeshëm të papunueshëm.
- # 7 Përcakton të gjitha pjesët dhe prejardhjet, përveç:
- a) farave dhe pjalmi;
- b) kulturat që rriten me farë ose inde të marra in vitro, në ambient të ngurtë ose të lëngshëm, transportuar në mbajtëse sterile;
- c) lule të prera të bimëve të shumëzuara artificialisht;
- d) frutat dhe pjesët e prejardhjet e bimëve të shumëzuara artificialisht të gjinisë Vanilla.
- # 8 Përcakton të gjitha pjesët dhe prejardhjet, përveç:
- a) farave dhe pjalmi;
- b) kulturave që rriten me farë ose inde të marra in vitro, në ambient të ngurtë ose të lëngshëm, transportuar në mbajtëse sterile;
- c) prodhime farmaceutike të përfunduara.

12. Kur thuhet që asnjë prej specieve ose taksonit më të lartë të florës përfshirë në shtojcën I është shënuar që hibridet e tij duhet të trajtohen në përputhje me kushtet e nenit III të Konventës, kjo nënkupton që hibridet e shumëzuara artificialisht prodhuar prej një ose më shumë prej këtyre specieve ose taksonëve mund të trajtohen me certifikatë të shumëzimit artificial dhe që farat dhe pjalmi, lulet e prera, kulturat e rritura me farë ose inde të marra in vitro, në mjedis të ngurtë ose të lëngët, transportuar në mbajtëse sterile të këtyre hibrideve, nuk janë objekt i kërkesave të Konventës.

L I G J
Nr.9022, datë 6.3.2003

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SPECIFIKE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË NË
MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE PËR DECENTRALIZIMIN
DHE QEVERISJEN VENDORE”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja specifike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë në mbështetje të projekteve për decentralizimin dhe qeverisjen vendore”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3760, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

MARRËVESHJE
SPECIFIKE NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SUEDISË NË MBËSHTETJE TË PROJEKTEVE PËR DECENTRALIZIMIN DHE
QEVERISJEN LOKALE

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë (këtu e më poshtë referuar si Shqipëria) dhe Qeveria Suedeze (këtu e më poshtë referuar si Suedia) kanë rënë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1
Delegimi i pushtetit

Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim, SIDA dhe Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit në Shqipëri janë të autorizuar që të përfaqësojnë qeveritë e tyre përkatëse në çështje që kanë të bëjnë me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Qëllimi dhe objektivat e Marrëveshjes

Suedia ka vendosur të ndihmojë Ministrinë e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit në Shqipëri duke financuar me ndihmë teknike në procesin e decentralizimit dhe zhvillimin e qeverisjes vendore në nivel qendror dhe në qarkun e Korçës.

Objektivi kryesor i projektit është të promovojë një strategji për decentralizimin dhe të kontribuojë për të realizuar ambicien e tij kryesore për zbutjen e varfërisë duke ngritur një mënyrë jetese të qëndrueshme, si dhe shërbime të përshtatshme shëndetësore, arsimim, infrastrukturë dhe shërbime publike. Përderisa na është ngarkuar kjo sfidë, duhet të forcohet demokracia, barazia, qeverisja e mirë, si dhe mbrojtja e mjedisit. Një provë e detajuar, për planifikimin e zhvillimit rajonal dhe lokal dhe për zbatimin e projektit, duhet të karakterizojë përpjekjet e përbashkëta.

Objektivat specifike janë:

a) Të lehtësojnë zhvillimin e kompetencave, përsa u përket attributeve, aftësive, njohurive dhe që u përkasin përfaqësuesve të zgjedhur, si dhe stafit profesional në të gjitha nivelet është zhvilluar në një linjë me kërkesat e politikës së re të decentralizimit.

b) Të lehtësojnë zhvillimin e kapaciteteve të përgjithshme të qeverisjes vendore në nivel bashkie dhe komunash si dhe në nivel rajonal, në mënyrë që të përballen me sfidën e përfundimit të një materiali të arsyeshëm të standardit të jetesës, shërbimeve publike dhe një mënyrë të qëndrueshme në qarkun e Korçës.

c) Të lehtësojnë zhvillimin e njohurive dhe metodave përkatëse për të analizuar tendencat ekonomike dhe demografike, formulimin e programeve të zhvillimit dhe zbatimit të projekteve, të hartojë një punë të vazhdueshme (bazë të dhënash për projektin e migrimit të popullsisë) në qarkun e Korçës.

d) Të përmirësojnë kompetencën e një funksionimi specifik, si dhe strukturat administrative dhe strukturën institucionale në njësitë e qeverisjes vendore dhe në nivel ministrie.

e) Të rrisë rolin mirëkuptues të të gjitha palëve të interesuara për ndërtimin e një shoqërie civile demokratike me anë të një shkalle të lartë të decentralizimit të vendimmarrjes.

Neni 3
Kontributi suedez

Suedia do t'i nënshtrohet një përcaktimi nga Kuvendi përsa u përket fondeve, për të mbështetur zbatimin dhe monitorimin e projektit, siç është specifikuar në Marrëveshje brenda një shume prej afërsisht 17 500 000 korona suedeze (shtatëmbëdhjetë milionë e pesëqind mijë korona suedeze). Shuma ekzakte do të përcaktohet pasi të sigurohet zbatimi. Shërbimet do të sigurohen nga SIDA dhe fondet do të përftohen përmes organizatës për sigurimin e zbatimit.

Neni 4

Iniciativat e Shqipërisë

Shqipëria merr përsipër:

- të sigurojë përdorimin efektiv të ndihmës së vënë në dispozicion nga kjo Marrëveshje dhe që ky kontribut të përdoret për qëllimet e rëna dakord;
- të sigurojë të gjitha burimet të cilave në bazë të Marrëveshjes, nuk u referuan si detyrime të Suedisë dhe të cilat janë të nevojshme për të realizuar një zbatim sa më efektiv të projektit. Kjo përfshin një staf të kualifikuar dhe fonde të mjaftueshme për koston periodike, si dhe për kapacitetet investuese;
- të ndërmarrë iniciativa koordinuese ndërmjet ministrive, donatorëve, autoriteteve ose institucioneve të tjera të përfshira në zbatimin e projektit;
- të ndihmojë dhe të bashkëpunojë me Suedinë për administrimin e kontrollit të brendshëm të projektburimeve dhe në kryerjen e ndonjë kontrolli të parë të nevojshëm nga Suedia. Inspektimi i regjistrimeve dhe dokumenteve, gjithashtu dhe ky kontroll mund të realizohen nga ndonjë agjenci e përshtatshme e zgjedhur nga Suedia.

Neni 5

Përdorimi i burimeve

Përdorimi i fondeve të mundësuar nga Suedia për projektin nuk duhet të pengohet ose të vonohet nga zhvillimet e bursës, ose kontrollet e këmbimit ndërkombëtar, ose taksat e vendosura nga Pala shqiptare. Asnjë nga këto taksa nuk do të paguhet nga kontributi suedez.

Nëse detyrimet doganore, taksat mbi shitjet ose tarifa të ngjashme do t'i vihen Palës suedeze, nga Pala shqiptare në mallra dhe burime të tjera financimi të siguruara nga Suedia, këto tarifa ose shpenzime do të paguhet nga Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit, në Shqipëri.

Licencat e nevojshme për të bërë importimin e financimeve nga Pala suedeze duhet të garantohen menjëherë nga Shqipëria.

Pala shqiptare duhet t'i japë Suedisë çdo informacion në lidhje me përdorimin e burimeve të siguruara prej saj, në mënyrë që Suedia në mënyrë të arsyeshme të kërkojë dhe të mundësojë një vizitë të përfaqësuesit suedez për të studiuar aktivitetet dhe për të inspektuar pronat, mallrat, regjistrat dhe dokumentet. Inspektimi i regjistrave dhe i dokumentacionit, si dhe kontrolli i tyre do të merret përsipër nga ndonjë agjenci e përshtatshme e zgjedhur nga Suedia.

Pala suedeze duhet t'i japë informacionin e nevojshëm Palës shqiptare për shpenzimet e bëra nga Suedia për këtë projekt.

Suedia dhe Shqipëria bien dakord që të bashkëpunojnë për parandalimin e korrupsionit brenda dhe gjatë gjithë projektit.

Suedia dhe Shqipëria iniciojnë të marrin masa të shpejta ligjore në vendet e tyre respektive për të ndaluar, hetuar dhe taksuar çdo palë të dyshuar si e korruptuar ose për çdo keqpërdorim të qëllimshëm të burimeve të projektit.

Neni 6

Kushtet për çatdhesimin e personelit, institucioneve dhe kompanive konsulente

Kur të bëhet çatdhesimi i personelit, institucioneve, kompanive konsulente dhe personelit tjetër ligjor nga vende të tjera përveç Shqipërisë, të angazhuar nga Pala suedeze për të kryer detyrat e tyre në Shqipëri, brenda kuadrit të projektit, do të zbatohen kushtet e mëposhtme:

- Ata duhet të kenë të drejtën të importojnë dhe të rieksportojnë, duke qenë jashtë detyrimeve doganore dhe detyrimeve të tjera të ngjashme, pajisjet profesionale dhe mallrat që u nevojiten për të realizuar angazhimin e tyre ose të shesin pajisje të tilla brenda Shqipërisë kundrejt pagesës në doganë dhe detyrimeve të ngjashme, kur nuk nevojiten më për kryerjen e këtyre shërbimeve.

- Ata duhet të kenë të drejtën të hapin llogari të jashtme financiare dhe të operojnë me to për përmbushjen e angazhimit të tyre. Dorëzimi efektiv i llogarive nuk duhet të pengohet nga kontrollet e jashtme të bursës dhe bilancet në këto llogari të jashtme duhet të transferohen lirisht në çdo kurs këmbimi.

- Ata duhet të jenë përjashtuar nga të gjitha detyrimet e mundshme për t'u regjistruar në Shqipëri për dhënie autorizimi profesional, taksa apo arsye të tjera dhe nuk do të ketë asnjë detyrim për të dhënë informacion tek autoritetet e tatim taksave të Shqipërisë, përderisa ato po kryejnë aktivitet tregtar në Shqipëri që nuk përjashtohet nga kjo Marrëveshje.

- Mospengim dhe dhënie pa pagesë e vizës, hyrje e shumëfishhtë, viza për rihyrje dhe dalje gjatë gjithë kohëzgjatjes së veprimtarisë së tyre.

- Lëvizje të lirë brenda vendit dhe e drejta për të hyrë dhe për t'u larguar nga vendi në masën e nevojshme për të çuar më tej zbatimin e projektit.

- Dhënie e menjëhershme e të gjitha lejeve dhe licencave të kërkuara, siç është leja e qëndrimit, lejet e punës dhe përjashtimin nga kufizimet e emigrantit dhe regjistrimit si i huaj dhe lejet profesionale, gjatë periudhës që ata ushtrojnë veprimtarinë e tyre për zbatimin e projektit.

- Përjashtimi nga tatimi mbi të ardhurat personale dhe nga ndonjë tatim tjetër në aspektin e shpërblimeve të paguara nga SIDA apo nga ndonjë punonjës, i cili është i ngarkuar të kryejë shërbime ose të shpërndajë mallra në një kontratë direkte me SIDA-n ose si nënkonsulent.

- Dhënia e shërbimit mjekësor dhe lehtësirave në këtë fushë në nivelin më të lartë cilësor që ka vendi, pavarësisht nga shërbimi publik ose privat. Një pagesë normale do të jepet si kamatëvonesë nga Suedia. Shpenzimet do të financohen nga fondi suedez për projektin.

- Këto kushte duhet të zbatohen edhe për bashkëshortët, bashkëjetuesit dhe të gjithë ata që kanë lidhje me personelin.

Neni 7

Kushtet për të përfituar kontribut suedez

1. Vetëm shpenzimet për aktivitetet e marra përsipër gjatë periudhës së përcaktuar në projektdokument do të jenë pjesë e kontributit financiar suedez. Pas një periudhe gjashtë mujore nga data e mbarimit, kontributi në këtë Marrëveshje nuk do të jetë më në dispozicion për disbursim. Nëse aktivitetet, pas datës finale të periudhës së përcaktuar për projektin, nuk janë financuar nga një marrëveshje tjetër, personeli mund të financohet nga kjo Marrëveshje në kuadrin e shpenzimeve të përcaktuara gjatë kontratave individuale të punësimit, deri në një periudhë maksimale prej gjashtë muajsh, duke pasur parasysh që titullarët të kenë rënë dakord, në kohën e punësimit ose ripërtëritjes së kontratës, për të zgjeruar periudhën e punësimit përtej afatit të mësipërm.

2. Në çdo kohë Suedia mund të tërheqë disbursimet: nëse bëhen devijime në planin dhe buxhetin e rënë dakord; nëse keqpërdoren fondet ose burimet e tjera; nëse burimet që duhet të siguroheshin nga Shqipëria nuk janë realizuar siç ishte planifikuar; nëse objektivat e projektit/programit janë të rrezikuara; nëse nuk është bërë shpërndarja e raporteve siç është rënë dakord; nëse menaxhimi financiar i projektit/programit është i kënaqshëm; nëse projekti zhvillohet në mënyrë jo të favorshme, përsa i përket objektivave në ndonjë aspekt tjetër të rëndësishëm.

Neni 8

Prokurimi

Asnjë ofertë, dhuratë ose lloj tjetër pagese, përfitime ose konstatime të këtij lloji të cilat do të apo mund të shfaqen si praktika korruptive dhe ilegale, nuk do të pranohen si direkt po ashtu edhe indirekt si tentativa për të shpërblyer vlerën e kryerjes së kontratës së financuar brenda këtij programi.

Suedia do të sigurojë ose do të bëjë të mundur sigurimin e të gjitha mjeteve, punëve dhe shërbimeve brenda këtij projekti. Për prokurimin e mjeteve, punimeve dhe shërbimeve të marra përsipër nga Suedia, udhëzuesi i bashkëngjitur për sigurimin "Udhëzuesi i përgjithshëm për sigurimin e mjeteve, punimeve dhe shërbimeve nën ndihmën financiare të Palës suedeze (miratuar më 19 dhjetor 1997 ose ndonjë dokumenti tjetër nga SIDA që mund ta zëvendësojë atë, do të aplikohet.

Neni 9

Raportimi dhe procedurat e tjera të zbatimit

Menaxhimi i projektit do të formulojë një raport fillestar, raporte periodike dhe një raport

përfundimtar për Palën marrëse (Ministria e Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit) për komente.

Pa marrë parasysh raportet e përsëritura për të cilat është rënë dakord, Palët menjëherë duhet të informojnë njëra-tjetrën, nëse ndodh një situatë e tillë që projekti të mos zhvillohet, siç është rënë dakord në Marrëveshje.

Neni 10

Referimi në marrëveshje të tjera

Bashkëpunimi ndërmjet dy Palëve në këtë Marrëveshje gjithashtu është përcaktuar nga:

- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë mbi terma dhe kushte të përgjithshme për zhvillimin e bashkëpunimit për periudhën nga 5 prill 2001 deri më 31 dhjetor 2005.
- Marrëveshja për zhvillimin e bashkëpunimit për periudhën 2001-2002, nënshkruar më 5 prill 2001.
- Ndonjë marrëveshje që mund të zëvendësojë ose rregullojë marrëveshjet e përmendura.

Neni 11

Shpërndarja e kësaj Marrëveshjeje

Palët marrin përsipër t'u shpërndajnë kopjet e kësaj Marrëveshjeje, të gjitha ministrive dhe autoriteteve të tyre dhe institucioneve të tjera të përfshira në programin e bashkëpunimit ose nga ana tjetër në nevojën për të informuar për përmbajtjen e saj.

Neni 12

Përfundimi

Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme deri në 31 dhjetor 2005, vetëm në qoftë se bëhet njoftimi me shkrim tre muaj më përpara nga çdonjëra prej Palëve.

Neni 13

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi pas njoftimit të të dy Palëve mbi përfundimin e procedurave të brendshme ligjore, për hyrjen në fuqi.

L I G J

Nr.9023, datë 6.3.2003

PËR KRIJIMIN E AGJENCISË SË NXITJES SË EKSPORTEVE (ANE)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

KREU I DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

1. Objekte të këtij ligji janë krijimi i Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve, përcaktimi i fushës së veprimtarisë dhe parimeve e rregullave të përgjithshme për organizimin dhe funksionimin e saj.

2. Organizimi, funksionimi dhe veprimtaria e Agjencisë së Nxitjes së Eksporteve përcaktohen në statutin e saj, i cili miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Neni 2

Agjencia e Nxitjes së Eksporteve, që më poshtë përdoret ANE, është person juridik publik me seli në Tiranë dhe e ushtron veprimtarinë e vet në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

Fusha e veprimtarisë së ANE-së është nxitja e eksporteve shqiptare nëpërmjet:

- a) nxitjes së prodhimit vendas për eksport dhe produkteve vendase për në tregjet e huaja;
- b) gjetjes së mundësive për eksporte dhe promovimit të tyre;
- c) bashkëpunimit me institucionet publike, financiare, organizata të biznesit dhe të investitorëve, me qëllim zbatimin e strategjisë kombëtare për nxitjen e eksporteve;
- ç) propozimit të politikave dhe mbështetjes së programeve dhe projekteve në nivel kombëtar, rajonal dhe sektorial për nxitjen e eksporteve;
- d) zhvillimit të veprimtarive të promocionit, brenda dhe jashtë vendit, në funksion të marketingut të produkteve shqiptare për eksport;
- dh) dhënies së asistencës shoqatave dhe shoqërive në bazë sektori dhe produkti;
- e) sigurimit, mbledhjes, përpunimit dhe shpërndarjes së të dhënave të duhura brenda dhe jashtë Shqipërisë për nxitjen e eksportit në mënyrë që të lehtësojë një rritje të konsiderueshme të sektorit privat;
- ë) publikimit të të dhënave zyrtare për eksportet shqiptare.

Neni 4

Institucionet shtetërore, qendrore dhe vendore, janë të detyruara të bashkëpunojnë me ANE-në, të shkëmbejnë të dhëna dhe të krijojnë të gjitha lehtësitë për përmbushjen e qëllimeve dhe të funksioneve të veprimtarisë së saj.

Neni 5

1. ANE-ja, në përputhje me ligjin, ka të drejtë të ketë në pronësi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe të realizojë të ardhura nëpërmjet shërbimeve që kryen në funksion të qëllimit dhe të fushës së veprimtarisë së vet.

2. ANE-ja nuk lejohet të ushtrojë veprimtari fitimprurëse.

3. ANE-ja përgjigjet për detyrimet ndaj të tretëve me mjetet e veta.

KREU II
ORGANET DREJTUESE TË ANE-SË

Neni 6

1. Organet drejtuese të ANE-së janë:
 - a) Këshilli Mbikëqyrës;
 - b) Drejtori Ekzekutiv.
2. Procedurat e emërimit dhe të lirimit nga detyra të Drejtorit Ekzekutiv përcaktohen në statutin e ANE-së.
3. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës, mënyra dhe masa e shpërblimit të anëtarëve të tij përcaktohen në statutin e ANE-së.

Neni 7

Drejtimi i veprimtarisë së përditshme dhe përfaqësimi i ANE-së në marrëdhënie me të tretët bëhet nga Drejtori Ekzekutiv, në përputhje me këtë ligj dhe me statusin e ANE-së.

KREU III
FINANCAT E ANE-SË

Neni 8

1. Burimet e financimit të veprimtarisë së ANE-së janë:
 - a) Buxheti i Shtetit;
 - b) donatorë të ndryshëm;
 - c) të ardhurat nga shërbimet dhe projektet e realizuara nga ANE-ja.
2. Veprimtaria e ANE-së financohet nga Buxheti i Shtetit, në përputhje me situatën financiare.
3. Llogaritë e ANE-së kontrollohen nga ekspertë kontabël të autorizuar.
4. Viti financiar i ANE-së fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor.

KREU IV
DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 9

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet e nevojshme nënligjore për zbatimin e këtij ligji dhe të rregullojë marrëdhëniet e parashikuara në nenet 1 dhe 8 të këtij ligji.

Neni 10

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3764, datë 27.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9024, datë 6.3.2003

**PËR AKREDITIMIN E LABORATORËVE TESTUES, KALIBRUES, ORGANIZMAVE
CERTIFIKUES DHE INSPEKTUES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Qëllimi

Ky ligj përcakton rregullat për krijimin dhe funksionimin e sistemit të akreditimit, përcakton fushat ku kryhet akreditimi dhe rolin e akreditimit në procedurat e vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike.

Neni 2

Përkufizime

Në zbatim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Akreditim" kuptohet procedura e njohjes zyrtare, nga një organizëm i autorizuar, të kompetencës së një organizmi të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike, për të kryer detyra të tilla, si testim, kalibrim, certifikim, inspektim.
2. "Autorizim" kuptohet dhënia e së drejtës për të kryer vlerësimin e përputhjes me standardet dhe rregullat teknike të produkteve, proceseve, shërbimeve në sferën e detyrueshme, organizmave publikë ose privatë, vendas ose të huaj, që kryejnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, nga ministritë dhe institucionet qendrore të fushës përkatëse.
3. "Certifikatë akreditimi" kuptohet dokumenti në bazë të të cilit tregohet kompetenca në kryerjen e detyrave të veçanta, në fushën e vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike.
4. "Certifikim" kuptohet veprimtaria e një pale të tretë e të pavarur, e cila vërteton nëse procesi, shërbimi ose produkti në fjalë plotëson kërkesat e veçanta të standardeve përkatëse, rregullat teknike ose aktet normative në fuqi.
5. "Inspektim" kuptohet veprimtaria që kryhet për të vlerësuar fazat e projektimit të produktit, procesit dhe shërbimit, në përputhje me kërkesat konkrete, në bazë të gjykimit profesional ose të kriterëve kryesore.
6. "Kalibrim" kuptohet tërësia e veprimeve që përcakton, në kushte të veçanta, marrëdhënien ndërmjet vlerave të treguara nga një mjet matës ose sistem matës, ose të vlerave të dhëna nga një matje materiale, si dhe vlerave të njohura, korresponduese të mjetit të matur.
7. "Organizëm i vlerësimit të përputhjes" kuptohet organizmi publik ose privat, i propozuar nga ministria ose institucioni tjetër qendror përkatës, i miratuar nga Këshilli i Ministrave.
8. "Sferë e detyruar" kuptohet sfera, subjekt i vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike, të detyrueshme të produkteve, proceseve dhe shërbimeve, si siguria e jetës, mbrojtja e shëndetit dhe e mjedisit.
9. "Testim" kuptohet veprimtaria teknike, që ka të bëjë me përcaktimin e një ose më shumë karakteristikave të një produkti, materiali, pajisjeje, organizmi, fenomeni fizik, procesi ose shërbimi të dhënë, sipas një procedure të veçantë.
10. "Vlerësim përputhjeje" kuptohet veprimtaria, e cila ka për qëllim përcaktimin e drejtpërdrejtë ose të tërthortë, për të vërtetuar nëse është plotësuar tërësia e kërkesave të një përcaktimi teknik apo standardi.

KREU II ORGANIZIMI

Neni 3

Drejtoria e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë

Për kryerjen e funksioneve të akreditimit krijohet Drejtoria e Akreditimit në Republikën e Shqipërisë, e cila më poshtë do të quhet Drejtoria e Akreditimit. Organizimi dhe funksionimi i saj përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 4

Varësia dhe drejtimi

1. Drejtoria e Akreditimit është institucion buxhetor, në varësi të Ministrit të Ekonomisë.
2. Ajo drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. Statusi i Drejtorit të Përgjithshëm dhe i punonjësve të Drejtorisë së Akreditimit rregullohet me ligjin nr.8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil".

Neni 5

Detyrat e Drejtorisë së Akreditimit

Drejtoria e Akreditimit ka këto detyra:

- a) akreditimin e laboratorëve të testimit/provave;
- b) akreditimin e laboratorëve kalibruës;
- c) akreditimin e organizmave certifikues;
- ç) akreditimin e organizmave inspektues;
- d) mbikëqyrjen e organizmave të akredituar;
- dh) ndërprerjen dhe tërheqjen e akreditimit;
- e) përfaqësimin e Republikës së Shqipërisë në organizmat ndërkombëtarë për akreditimin;
- ë) bashkëpunimin me organizmat kombëtarë të akreditimit në vendet e tjera për arritjen e marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, ose për të arritur marrëveshje dypalëshe;
- f) dhënien e këshillave në administratën shtetërore për çështje që lidhen me akreditimin dhe vlerësime të tjera të kompetencës teknike, për kryerjen e procedurave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike;
- g) mbajtjen, azhurnimin dhe dhënien e informacionit për statusin e akreditimit të organizmave të akredituar;
- gj) bashkëpunimin me Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, ministritë përkatëse dhe shoqatat e interesuara për çështjet e akreditimit.

KREU III PARIMET E AKREDITIMIT

Neni 6

Bazat ligjore

Akreditimi në Republikën e Shqipërisë bazohet në legjislacionin në fuqi, në standardet ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë dhe dokumente të tjera të nxjerra nga organizmat ndërkombëtarë të akreditimit.

Neni 7

Parimet e akreditimit

Akreditimi bazohet në parimet e paanshmërisë, transparencës dhe përgjegjësisë profesionale. Drejtoria e Akreditimit është e pavarur nga çdo organizëm i vlerësimit të përputhjes në standardet dhe rregullat teknike dhe ajo nuk përfshihet në këto veprimtari.

Neni 8

Vlerësimi i aftësisë dhe i përgjegjësisë teknike

Drejtoria e Akreditimit vlerëson aftësinë teknike të organizmave të vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike, e cila merret për bazë në dhënien e autorizimit nga organet përkatëse. Ato bëjnë vlerësimin e statusit ligjor dhe aftësisë ekonomike të tyre.

Neni 9

Akreditimi nga organizma ndërkombëtarë

Akreditimi për organizmat e vlerësimit të përputhjes me standardet dhe rregullat teknike mund të kryhet edhe nga organizma të huaj akreditimi, të cilët janë anëtarë të marrëveshjeve të njohjes së ndërsjellë, rajonale ose ndërkombëtare, ku edhe Drejtoria e Akreditimit është anëtare ose me të cilat ajo ka marrëveshje dypalëshe.

Neni 10

Tarifat e akreditimit dhe miratimi i tyre

Tarifat për kryerjen e të gjitha shërbimeve nga Drejtoria e Akreditimit propozohen nga kjo e fundit dhe miratohen nga Ministri i Financave. Këto tarifa janë të njëjta, si për subjektet vendase, ashtu dhe për ato të huaja, të cilat ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë.

Neni 1

Shpenzimet e akreditimit

Akreditimi kryhet në bazë të kërkesave të palëve të interesuara.

2. Të gjitha shpenzimet për akreditimin dhe mbikëqyrjen, në përputhje me standardet dhe procedurat përkatëse, mbulohen nga pala e interesuar që ka bërë kërkesë, sipas tarifave të përcaktuara nga Ministria e Financave.

3. Të ardhurat e siguruara nga këto shërbime derdhen në Buxhetin e Shtetit.

KREU IV

KUNDËRVAJTJET ADMINISTRATIVE

Neni 12

Kundërvajtjet

Përdorimi i stemës së akreditimit nga subjekte të paakredituara apo që u ka mbaruar afati i akreditimit përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 5 000 (pesë mijë) lekë deri në 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, prej punonjësit të autorizuar nga Drejtoria e Akreditimit.

Neni 13

Ankimi administrativ

1. Kundër vendimit të dënimit administrativ mund të bëhet ankim te Drejtori i Drejtorisë së Akreditimit brenda 15 ditëve. Ai duhet të përgjigjet brenda 30 ditëve nga data e ankimit.

2. Kundër vendimit të Drejtorit të Drejtorisë së Akreditimit ose kur ai nuk përgjigjet mund të bëhet ankim në gjykatë brenda 30 ditëve.

KREU V
DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 14

1. Sektori i Akreditimit në Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimeve do të kryejë veprimtarinë e akreditimit derisa të fillojë të funksionojë Drejtoria e Akreditimit.
2. Procedurat e akreditimit, të filluara përpara miratimit të akteve nënligjore nga Këshilli i Ministrave, do të kryhen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Neni 15

1. Në ligjin nr.8464, datë 11.3.1999 "Për standardizimin", bëhen këto ndryshime:
 - a) në nenin 1, fjalia "Akreditimit të laboratorëve të provave, organizmave certifikues të produkteve, sistemeve të cilësisë, personelit dhe organizmave inspektues" shfuqizohet;
 - b) neni 2 shfuqizohet;
 - c) në nenin 7, fjalia "Për drejtimin, organizimin dhe kontrollin e punës për akreditimin", shfuqizohet;
 - ç) në nenin 9:
 - (i) në pikën 2 fjalia "Ndjekjen e procedurave të akreditimit" shfuqizohet;
 - (ii) pika 5 shfuqizohet;
 - (iii) në pikën 8 fjalia "Lidhjen e marrëveshjeve me organet homologe për njohjen e ndërsjellë të raportanalizave të laboratorëve të akredituar" shfuqizohet.

Neni 16

Dispozita të fundit

Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3 dhe 14 të këtij ligji.

Neni 17

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3765, datë 27.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

L I G J
Nr.9025, datë 13.3.2003

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV ME FUQINË E LIGJIT NR.1, DATË 9.3.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR VËNIEN NË DISPOZICION TË HAPËSIRËS
TOKËSORE, DETARE E AJRORE DHE DËRGIMIN E NJË FORCE USHTARAKE
SHQIPTARE NË RAJONIN E GJIRIT PERSIK, NË KUADËR TË KOALICIONIT
NDËRKOMBËTAR TË LUFTËS KUNDËR TERRORIZMIT”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Miratohet akti normativ me fuqinë e ligjit nr.1, datë 9.3.2003, i Këshillit të Ministrave “Për vënien në dispozicion të hapësirës tokësore, detare e ajrore dhe dërgimin e një force ushtarake shqiptare në rajonin e Gjirit Persik, në kuadër të koalicionit ndërkombëtar të luftës kundër terrorizmit”.

**Shpallur me dekret nr.3751, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

**L I G J
Nr.9026, datë 13.3.2003**

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË “KONVENTËN PËR NJOFTIMIN E
SHPEJTË TË NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR”**

Në mbështetje të neneve 78, 81 pika 1, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

V E N D O S I:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në “Konventën për njoftimin e shpejtë të një aksidenti bërthamor”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekret nr.3752, datë 26.3.2003 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**

KONVENTË

PËR NJOFTIMIN E SHPEJTË TË NJË AKSIDENTI BËRTHAMOR

Shtetet Pjesëmarrëse të kësaj Konvente:

të ndërgjegjshëm se veprimtaritë bërthamore po zhvillohen në një numër shtetesh;

duke vërejtur se janë marrë masa dhe po merren masa të gjithanshme për të siguruar një nivel të lartë sigurie në veprimtaritë bërthamore, me qëllim që të parandalohen aksidentet bërthamore dhe të minimizohen pasojat e ndonjë aksidenti të tillë, në qoftë se ai ndodh;

duke dëshiruar të forcojnë më tej bashkëpunimin ndërkombëtar për një zhvillim dhe përdorim të sigurt të energjisë bërthamore;

të bindur për nevojën që kanë shtetet për të administruar një informacion të bazuar në lidhje me aksidentet bërthamore sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim që pasojat radiologjike ndërkufitare të mund të minimizohen;

duke vërejtur dobinë e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe për shkëmbim informacioni në këtë fushë,

ranë dakord për sa më poshtë:

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Kjo Konventë do të zbatohet në rastin e çdo aksidenti që përfshin objekte ose veprimtari të një Shteti Pjesëmarrës ose të personave ose subjekteve juridike nën juridiksionin ose kontrollin e tij, sipas paragrafit 2 të mëposhtëm, që çon ose pritet të çojë në çlirim lëndësh radioaktive dhe që rezulton ose mund të rezultojë në kalimin e këtyre lëndëve përtej kufijve shtetëror, ngjarje e cila mund të jetë e rëndësishme për sigurinë radiologjike të një shteti tjetër.

2. Objektet dhe veprimtaritë, të cilave u referohet paragrafi 1 janë:

- a) çdo reaktor bërthamor kudo që të jetë vendosur;
- b) çdo impiant me cikël karburanti bërthamor;
- c) çdo impiant që trajton mbetje radioaktive;
- d) transporti dhe magazinimi i karburantit bërthamor ose i mbetjeve radioaktive;
- e) prodhimi, përdorimi, ruajtja, groposja dhe transporti i radioizotopeve për qëllime mjekësore, bujqësore, industriale, dhe në lidhje me kërkimin dhe shkencën në këto fusha;
- f) përdorimi i radioizotopeve për përfitim (gjenerim) energjie në objektet në hapësirën kozmike.

Neni 2

Njoftimi dhe informimi

Në rast të ndonjë aksidenti të përcaktuar në nenin 1 (që këtej e tutje do të quhet “aksident bërthamor”), Shteti Pjesëmarrës, të cilit i referohet ai nen duhet:

a) Të njoftojë menjëherë, direkt ose nëpërmjet Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (që këtej e tutje do të quhet “Agjencia”) ato shtete, që janë ose mund të jenë fizikisht të ndikuara sikurse përcaktohet në nenin 1 dhe Agjencinë, për aksidentin bërthamor, natyrën e tij, kohën e ndodhjes dhe vendndodhjen e saktë, kur është e nevojshme.

b) T’u japë menjëherë informacionin e duhur shteteve që u referohet nënparagrafi (a), direkt ose nëpërmjet Agjencisë, në mënyrë që të pakësohen pasojat radiologjike në këto shtete, sikurse specifikohet në nenin 5.

Neni 3

Aksidente të tjera bërthamore

Me qëllim që të pakësohen pasojat radiologjike, Shtetet Pjesëmarrëse mund të njoftojnë edhe për raste aksidentesh bërthamore të ndryshme nga ato që tregohen në nenin 1.

Neni 4
Funksionet e Agjencisë

Agjencia:

a) Do të njoftojë menjëherë Shtetet Pjesëmarrëse, Shtetet Anëtare, shtetet e tjera që janë ose mund të jenë fizikisht të ndikuara sikurse specifikohet në nenin 1 dhe organizatat ndërqeveritare ndërkombëtare relevante (që këtej e tutje do të quhen “organizata ndërkombëtare”) për çdo njoftim të marrë në përputhje me nënparagrafin (a) të nenit 2.

b) Do t’ua japë menjëherë, me kërkesën e tyre, informacionin e marrë sipas nënparagrafit (b) të nenit 2 çdo Shteti Pjesëmarrës, Shteti Anëtar ose organizate ndërkombëtare relevante .

Neni 5
Informacioni që duhet të jepet

1. Informacioni që do të jepet sipas nënparagrafit (b) të nenit 2 do të përmbajë të dhënat e mëposhtme, sikurse ato disponohen nga Shteti Pjesëmarrës që bën njoftimin:

- a) Koha, vendndodhja e saktë, kur është e nevojshme dhe natyra e aksidentit bërthamor.
- b) Objekti ose veprimtaria e përfshirë.
- c) Shkaku i supozuar ose i njohur dhe parashikimi për zhvillimin e mëtejshëm të aksidentit bërthamor lidhur me daljen jashtë kufijve të lëndëve radioaktive.
- d) Karakteristikat e përgjithshme të daljes radioaktive, duke përfshirë sa është e mundur praktikisht dhe e nevojshme, natyrën, formën e mundshme fizike dhe kimike, sasinë, përbërjen dhe lartësinë efektive të daljes radioaktive.
- e) Informacion për kushtet meteorologjike dhe hidrologjike të çastit dhe të parashikuara për të ardhmen, të nevojshme për të parashikuar daljen jashtë kufijve të lëndëve radioaktive.
- f) Rezultatet e kontrollit të mjedisit lidhur me daljen jashtë kufijve të lëndëve radioaktive.
- g) Masat mbrojtëse jashtë vendit të aksidentit, të marra ose të planifikuara.
- h) Dinamika në kohë e parashikuar për daljen radioaktive.

2. Ky informacion do të plotësohet në intervale të përshtatshme me informacione të tjera relevante për zhvillimin e situatës së jashtëzakonshme, duke përfshirë përfundimin aktual ose të parashikuar të saj.

3. Informacioni i marrë sipas nënparagrafit (b) të nenit 2, mund të përdoret pa kufizime, përveç rasteve kur ky informacion është siguruar nëpërmjet njoftimit konfidencial nga ana e Shtetit Pjesëmarrës.

Neni 6
Këshillimet

Një Shtet Pjesëmarrës që jep informacion sipas nënparagrafit (b) të nenit 2 në atë masë që është e arsyeshme, do t’i përgjigjet menjëherë kërkesës për informacion të mëtejshëm ose për këshillime, që vjen prej një Shteti Pjesëmarrës të ndikuar nga aksidenti, në mënyrë që të pakësohen pasojat radiologjike në atë shtet.

Neni 7
Autoritetet kompetente dhe pikat e kontaktit

1. Çdo Shtet Pjesëmarrës do t’u bëjë të ditur Agjencisë dhe Shteteve të tjera Pjesëmarrëse, direkt ose nëpërmjet Agjencisë, autoritetet e veta kompetente dhe pikën e kontaktit, që është përgjegjëse për dhënien dhe marrjen e njoftimit dhe informacionit sipas nenit 2. Këto pika kontakti dhe një pikë qendrore brenda Agjencisë do të jenë të disponueshme në mënyrë të vazhdueshme.

2. Çdo Shtet Pjesëmarrës do të njoftojë menjëherë Agjencinë për çdo ndryshim që mund të ndodhë në informacionin sipas paragrafit 1.

3. Agjencia do të mbajë një listë të azhurnuar të këtyre autoriteteve kombëtare, si dhe pikave të kontaktit të organizatave ndërkombëtare relevante dhe do ta shpërndajë këtë listë tek të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse, Shtetet Anëtare dhe organizatat ndërkombëtare relevante.

Neni 8

Ndihma për Shtetet Pjesëmarrëse

Agjencia në përputhje me statutin e saj dhe me kërkesën e një Shteti Pjesëmarrës që nuk ka veprimtari të veta bërthamore dhe as kufij me një shtet jopjesëmarrës që zhvillon një program aktiv bërthamor, do të bëjë studime për nevojën dhe vendosjen e një sistemi të përshtatshëm monitorimi të rrezatimeve, në mënyrë që të lehtësojë arritjen e objektivave të kësaj Konvente.

Neni 9

Marrëveshjet dypalëshe dhe shumëpalëshe

Në përputhje me interesat e tyre reciproke, Shtetet Pjesëmarrëse kur e shohin të përshtatshme, mund të marrin në konsideratë përfundimin e marrëveshjeve dypalëshe ose shumëpalëshe lidhur me çështjet që trajton kjo Konventë.

Neni 10

Lidhja me marrëveshjet e tjera ndërkombëtare

Kjo Konventë nuk do të ndikojë mbi të drejtat dhe detyrimet reciproke të Shteteve Pjesëmarrëse, që rrjedhin nga marrëveshjet ekzistuese ndërkombëtare, të cilat lidhen me çështje që mbulon kjo Konventë ose që rrjedhin nga marrëveshjet ndërkombëtare të së ardhmes të përfunduara në përputhje me objektin me qëllimin e kësaj Konvente.

Neni 11

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Në rast mosmarrëveshje ndërmjet Shteteve Pjesëmarrëse ose ndërmjet një Shteti Pjesëmarrës dhe Agjencisë, lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Konvente, palët që nuk merren vesh do të konsultohen, me qëllim që të zgjidhin mosmarrëveshjet me anë bisedimesh ose me ndonjë mjet tjetër paqësor të pranueshëm prej tyre.

2. Nëse një mosmarrëveshje e këtij karakteri ndërmjet Shteteve Pjesëmarrëse nuk mund të zgjidhet brenda një viti pas kërkesës për konsultim sipas paragrafit 1, me kërkesën e çdo pale në mosmarrëveshje, çështja i kalon arbitrazhit ose Gjykatës Ndërkombëtare për vendim. Nëse brenda gjashtë muajve nga data e kërkesës për të çuar mosmarrëveshjen në arbitrazh, palët janë të paafta të bien dakord për organizimin e arbitrazhit, çdo palë mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare ose Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara të caktojë një ose më shumë arbitra. Në rast kërkesash kontradiktore nga palët në mosmarrëveshje, kërkesat drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara do të kenë përparësi.

3. Gjatë nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit ose aderimit në këtë Konventë, një shtet mund të deklarojë se nuk e konsideron veten të lidhur nga njëra ose të dyja procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve të treguara në paragrafin 2, ndaj një Shteti Pjesëmarrës për të cilin mbetet në fuqi një deklaratë e tillë.

4. Një Shtet Pjesëmarrës, që ka bërë një deklaratë në përputhje me paragrafin 3, mund ta tërheqë atë në çdo kohë duke njoftuar Depozituesin.

Neni 12

Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për firmosje për të gjitha shtetet dhe nga Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë, në rezidencën e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike në Vjenë dhe në rezidencën e Kombeve të Bashkuara në Nju Jork prej 26 shtatorit 1986 dhe 6 tetorit 1986 përkatësisht, deri në hyrjen e saj në fuqi ose për dymbëdhjetë muaj, duke zgjedhur periudhën më të gjatë.

2. Një shtet dhe Namibia, e përfaqësuar nga Këshilli i Kombeve të Bashkuara për Namibinë,

mund të shprehin miratimin se bashkohen me këtë Konventë ose duke e firmosur, ose duke depozituar një instrument ratifikimi, pranimi ose miratimi të shoqëruar me firmosjen që bëhet subjekt ratifikimi, pranimi ose miratimi, ose duke depozituar një instrument aderimi. Instrumentet e ratifikimit, pranimi, miratimit ose aderimit do të depozitohen tek Depozituesi.

3. Kjo Konventë hyn në fuqi tridhjetë ditë pasi të jetë shprehur pranimi i saj nga tre shtete.

4. Për çdo shtet që shpreh pëlqimin për t'u lidhur me këtë Konventë pas hyrjes në fuqi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi për shtetin tridhjetë ditë pas datës së shprehjes së pëlqimit.

5. a) Kjo Konventë do të jetë e hapur për aderim, sikurse sigurohet nga ky nen, nga organizatat ndërkombëtare dhe organizatat rajonale integruese që formohen nga shtete sovraane, të cilat kanë kompetencat për të bërë negociata, përfundime dhe zbatime të marrëveshjeve ndërkombëtare për fusha që i mbulon kjo Konventë.

b) Brenda kompetencave të tyre këto organizata, në emër të tyre do të ushtrojnë të drejtat dhe do të plotësojnë detyrimet që kjo Konventë u atribuon Shteteve Pjesëmarrëse.

c) Kur depoziton instrumentin e vet të aderimit, një organizatë e tillë do t'i komunikojë Depozituesit një deklaratë, ku i tregon shtrirjen e kompetencave të saj në lidhje me fushat që mbulon kjo Konventë.

d) Një organizatë e tillë nuk përbën ndonjë votë shtesë për votat e Shteteve Pjesëmarrëse.

Shënim : Sipas nenit 12.3, Konventa hyri në fuqi me 27 tetor 1986.

Neni 13

Zbatimi i përkohshëm

Një shtet që nga momenti i firmosjes ose në çdo kohë tjetër përpara kohës së hyrjes në fuqi të kësaj Konvente për këtë shtet, mund të deklarojë se do të zbatojë këtë Konventë përkohësisht.

Neni 14

Amendamenti

1. Një Shtet Pjesëmarrës mund të propozojë amendamente për këtë konventë. Amendamenti i propozuar do t'i dërgohet Depozituesit, i cili do ta qarkullojë atë menjëherë në të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse.

2. Nëse shumica e Shteteve Pjesëmarrës i kërkon Depozituesit të thërrasë një konferencë për të shqyrtuar amandanentin e propozuar, Depozituesi do të ftojë të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse të vijnë në këtë konferencë që fillon jo më parë se tridhjetë ditë pas dërgimit të ftesave. Çdo amendament, që pranohet nga konferenca me dy të tretat e votave të të gjitha Shteteve Pjesëmarrëse, do të futen në një protokoll që është i hapur për firmosje në Vjenë dhe në Nju Jork nga të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse.

3. Protokollin hyn në fuqi tridhjetë ditë pas pëlqimit të shprehur nga tre shtete. Për çdo shtet që shpreh pëlqimin për të qenë i lidhur me këtë protokoll, pasi ai ka hyrë në fuqi, protokollin do të hyjë në fuqi tridhjetë ditë pas datës së shprehjes së pëlqimit.

Neni 15

Denoncimi

1. Një Shtet Pjesëmarrës mund ta denoncojë këtë Konventë duke njoftuar me shkrim Depozituesin.

2. Denoncimi merr fuqi një vit pas datës së marrjes së njoftimit nga Depozituesi.

Neni 16

Depozituesi

1. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të jetë Depozituesi i kësaj Konvente.

2. Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë do të njoftojë menjëherë të gjitha Shtetet Pjesëmarrëse dhe shtetet e tjera për:

a) çdo firmosje të kësaj Konvente ose ndonjë protokoll amendamenti;

- b) çdo depozitim të një instrumenti ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi lidhur me këtë Konventë ose me ndonjë protokoll amendamenti;
- c) çdo deklaratë ose tërheqje deklarate në përputhje me nenin 11;
- d) çdo deklaratë për zbatim të përkohshëm të kësaj Konvente sipas nenit 13;
- e) hyrjen në fuqi të kësaj Konvente ose të ndonjë amendamenti të saj;
- f) çdo denoncim të bërë sipas nenit 15.

Neni 17

Tekstet origjinale dhe kopjet e vërtetuara

Origjinali i kësaj Konvente, tekstet e së cilës në gjuhë arabe, kineze frënge, ruse dhe spanjolle janë njëllëj autentike, do të depozitohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike, i cili do t'u dërgojë kopje të vërtetuara Shteteve Pjesëmarrëse dhe të gjitha shteteve të tjera.

Si dëshmi e kësaj, nënshkruesi duke qenë i autorizuar sipas të gjitha rregullave, ka firmosur këtë Konventë të hapur për firmosje sipas paragrafit 1 të nenit 12.

Miratur nga Konferenca e Përgjithshme e Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike mbledhur në sesion të posaçëm në Vjenë, më 26.9.1986.

VENDIM I SHKURTUAR

Gjykata e Shkallës së Parë Tepelenë, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Shyqyri Matopalaj, i dalë lindjes 3.9.1943, lindur në Zhapokikë dhe banues në Tepelenë.

KËRKESË

Hetem Braho, lindur dhe banues në fshatin Kovacanj të rrethit Skrapar, kërkon shpalljen të zhdukur të djalit të tij Neim Braho.

KËRKUES
Hetem Braho

KËRKESË

Batire Myftaraj, kërkon shpalljen të vdekur të babait të saj Veliko Myftaraj.

KËRKUESE
Batire Myftaraj

KËRKESË

Enkeleda Balija, lindur më 1973 dhe banuese në Tiranë, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj Shpëtim Balija.

KËRKUESE
Enkeleda Balija

KËRKESË

Behare Aliaj, lindur më 1955 në Çorush të Mallakastrës dhe banuese në Vlorë, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit Petrit Aliaj.

KËRKUESE
Behare Aliaj

Fletorja Zyrtare gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
 - pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
- Rr. Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

Kodi Penal <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Mars, 2002	Kodi i Procedurës Penale <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Shtator, 2002	Kodi i Procedurës Civile <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Korrik, 2002	Kodi Rrugor <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Qershor, 2002
Kodi Penal Ushtarak <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002	Përmbledhëse legjislacioni në fushën e Përmbarimit <i>Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare</i> Tetor, 2002		

U dorëzua për shtyp më 27.3.2003

Doli nga shtypi më 28.3.2003

Tirazhi: 4300 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2003

Çmimi: 150 lekë